



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 465 Akti

Nr. 426 Vendimi
Tiranë, më 27.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Tonci Petkovic, në Tiranë, më 23.7.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Daniela Sulaj**, prokurore/magjistrate e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj (Konica), prokurore/magjistrate e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për znj. Daniela Sulaj (Konica) nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”) dhe komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (këtu e në vijim “KLP”).
11. **ILDKPKI-ja**, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti është konstatuar se:

- (a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor;*
- (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (c) ka mosdeklarime/deklarime të pasakta ndër vite;*
- (d) nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- (e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

13. Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në KLP ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit mbi të tria kriteret, në datën 2.7.2021 vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t' u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

16. Subjekti, u njoftua përmes postës elektronike të datës 2.7.2021 në lidhje me (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të drejtën e njohjes me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative (iv) të drejtën për të paraqitur prova të reja ose thirrjen e dëshmitarëve në kuptim të barrës së provës së lënë si dhe të drejtën për të paraqitur shpjegime, deri me datën 19.7.2021. Në vijim, subjekti e ushtroi të drejtën e njohjes me provat e administruara gjatë hetimit administrativ në datën 5.07.2021.

17. Në datën 7.7.2021 subjekti i rivlerësimit depozitoi disa prova shkresore dhe në vijim në datë 19.7.2021 dërgoi shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ si dhe provat e tjera në mbështetje të tyre.

18. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 21.7.2021 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 23.7.2021 ora 12:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.

19.1. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Daniela Sulaj ka qenë e gatshme për të bashkëpunuar me Komisionin gjatë procesit të rivlerësimit në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve, si dhe pyetjeve të drejtuara në seancën dëgjimore nga trupi gjykues, si dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit, parime këto, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

21.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, KLP-ja parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

21.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

¹41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi.

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, në vijim referuar deklarata “Vetting”, deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; b) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; c) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; ç) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; d) denoncimet e publikut; e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurive të subjektit dhe personave të lidhur me të, ligjshmërisë së burimit dhe krijimit të tyre.

22.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

22.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive. Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI më 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

23. Pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 71,5 m², ndodhur në rr. “****” pranë “Z.C”, Tiranë, për të cilën është lidhur kontrata e shitjes me kusht në korrik 2001 dhe kontrata përfundimtare e shitjes në gusht 2004; blerë dhe regjistruar në emër të bashkëshortit pas martesës. Vlera 34,000 USD ose në vlerën 4,904,287 lekë. Pjesa takuese 50%.

23.1. Si burim krijimi për këtë pasuri subjekti ka deklaruar qiranë mujore e 3 viteve të para tek “PSHM”, [tani “NOA”], të cilat konsideroheshin edhe këste mujore të kredisë prej 34,000 USD, me interes 5% dhe afat 20 vjet. Në vijim me nënshkrimin e kontratës finale të blerjes me PSHM-në, është marrë kredi nga BKT në vlerën 40,000 euro, një pjesë e së cilës është përdorur për të paguar vlerën e mbetur të kredisë së marrë pranë PSHM-së në shumën 30,815 USD.

23.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën fillestare të pasurisë datë 24.3.2004 është deklaruar nga subjekti si adresë banimi. Ndërsa në deklaratën periodike vijuese, në DPV/2004, subjekti e ka deklaruar pasurinë në vlerën 5,300,000 lekë, duke deklaruar si burim krijimi në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” kredi 40,000 euro për blerje apartamenti dhe ndërtim për afat 15 vjet dhe kredi nga PSHM, në vlerën 34,000 dollarë, për 3 vjet me interes 5%.

Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie

23.3. Nga hetimi administrativ i kryer në lidhje me këtë pasuri, ASHK-ja Tiranë² ka konfirmuar të regjistruar pasurinë në emër të bashkëshortit të subjektit z. P.S.

23.4. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2004, të lidhur midis z. P.S dhe subjektit “PSHM”, kundrejt çmimit 30,815 USD, i likuiduar plotësisht.

Mbi mënyrën e shlyerjes së çmimit dhe burimin e krijimit

23.5. Nga hetimi³ i Komisionit në lidhje me verifikimin e burimeve të krijimit deklaruar nga subjekti si dhe mënyrën e shlyerjes së çmimit për blerjen e pasurisë, ka rezultuar si më poshtë vijon:

23.6. Bashkëshorti i subjektit, z. P.S ka qenë i punësuar pranë PSHM-së dhe për shkak të marrëdhënies së punësimit i është ofruar apartamenti objekt vlerësimi kundrejt çmimit prej 34,000 USD, në përputhje me kushtet e një marrëveshjeje mirëkuptimi, të datës 10.07.2001⁴. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, pasuria i është dhënë me qira⁵ kundrejt pagesës mujore 224 dollarë amerikanë, për një afat kohor prej 30 muajsh, marrëdhënie kjo, e cila, pas plotësimit të këtij afati, është njohur nga institucioni si kredi me interes 5% dhe afat 20 vjet, duke e konsideruar qiranë e paguar nga bashkëshorti i subjektit si shlyerje principali të kredisë me detyrimin e mbetur për t’u paguar në shumën 30,500 USD. Në vijim, në datën 15.7.2004, kjo pasuri i është shitur subjektit kundrejt çmimit 30,500 USD.

23.7. E pyetur nga Komisioni për mënyrën e likuidimit të çmimit ndaj palës shitëse PSHM, subjekti ka sqaruar se vlera e shitjes së apartamentit prej 30,815 USD është paguar nga kredia me të njëjtën vlerë që është hapur për bashkëshortin e saj në datën e blerjes, datë 15.7.2004. Kjo vlerë nuk është paguar në *cash*, por ka pasur efekt në librat e llogarive të PSHM-së, pra, është shitur apartamenti dhe është hapur kredia për P.S për vlerën 30,815 USD.

23.8. Më tej, subjekti ka sqaruar se kredia e PSHM-së është shlyer në këtë mënyrë; në muajt gusht dhe shtator 2004, është shlyer nëpërmjet kryerjes së pagesave mujore prej 224 USD. Në vijim, më 1 tetor 2004, është lëvruar kredia prej 40,000 eurosh nga BKT-ja, nga e cila vlera prej 24,837.13 euro, pra, ekuivalenti i shumës 30,500 USD është transferuar për mbylljen e kredisë ndaj PSHM-së.

23.9. Banka Kombëtare Tregtare⁶ konfirmon se në datën 9.9.2004 midis shtetasve P.S dhe Daniela Sulaj është lidhur kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., me afat 15 vite, në shumën 40,000 euro, me objekt “blerje apartamenti”, për sigurimin e së cilës është vendosur hipotekë apartamenti objekt vlerësimi, sipas kontratës së hipotekës me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 9.9.2004.

² Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 16.6.2020 dhe në vijim dërgim praktika e plotë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 7.5.2021, pasuri e regjistruar në datën 23.8.2004 në regjistrin hipotekor me nr. ***.

³ Kërkesë me nr. *** prot., datë 7.4.2021 dhe kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 16.4.2021; kërkesë me nr. *** prot., datë 20.4.2021, NOA; kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 11.5.2021; kërkesë me nr. *** prot., datë 28.2.2020; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.5.2020; kërkesë me nr. *** prot., datë 6.4.2021 BKT; kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 30.4.2021.

⁴ Memorandum mirëkuptimi i lidhur midis institucionit financiar PSHM dhe z. P.S, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (aneksi nr. ***) në gjuhën angleze, akt i cili me kërkesën e Komisionit u paraqit në formën e kërkuar ligjore, i përkthyer.

⁵ Sipas kontratës së qirasë të lidhur midis palëve në datën 2.08.2001, dokumentacion i administruar nga dosja e ILDKPKI (aneksi nr ***)

⁶ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.5.2020 nga BKT.

23.10. Pas regjistrimit⁷ të inskriptit mbi apartamentin në favor të BKT-së, në datën 30.9.2004 është disbursuar kredia në vlerën 40,000 euro në llogari të personit të lidhur P.S dhe në vijim, në datën 1.10.2004, nga llogaria në euro e personit të lidhur, është konvertuar një pjesë e kredisë në valutën dollarë, pra, shuma 24,837 euro (ekuivalenti i vlerës 30,500 USD), ku brenda ditës kjo shumë është transferuar nga llogaria e personit të lidhur në favor të PSHM-së, me përshkrimin “P.S për PSHM Mikro Loans”.

23.11. Në përfundim të hetimit të kryer për këtë pasuri, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me: a) mosdeklarimin në deklaratën para fillimit të detyrës të pasurisë/të drejtat reale mbi të sipas nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003; b) mospërputhjen e deklarimeve në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit në deklaratat e pasurisë në raport me kontratën e shitblerjes; c) deklarimin e pasaktë të burimit të krijimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, për sa nga hetimi rezultoi se pasuria është blerë me hua të marrë nga institucioni huadhënës PSHM, hua e shlyer me kredinë e BKT-së.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas rezultateve të hetimit

24. Subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi në deklaratën e parë ka ardhur për arsye se nuk e ka pasur në pronësi pasurinë dhe pas fitimit të pronësinë në gusht të vitit 2004 është deklaruar në DPV 2004. Në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve në çmim, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim sikurse përgjatë hetimit, duke theksuar si shkak konvertimin valutës të çmimit të kontratës, i cili, sipas subjektit, nuk ka pasjellë asnjë efekt, pasi të gjitha transaksionet janë kryer në dollarë amerikanë.

24.1. Për sa i përket konstatimit për deklarim të pasaktë të burimit të krijimit, ka shpjeguar se ka ardhur nga moskuptimi i rolit të kredisë në këtë marrëdhënie, për shkak të mospërfshirjes së saj të drejtpërdrejtë në procedurën e kreditimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

25. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit për këtë pasuri vlerëson se: a) subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit të të drejtave reale të gëzimit dhe posedimit të apartamentit në DPV/2003, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”, sepse rezultoi e provuar nga hetimi se subjekti ka filluar të banojë në korrik të vitit 2001; b) dispozita ligjore në fuqi në kohën e deklarimit⁸, përbënte detyrim për subjektet të deklaronin pasuritë e grumbulluara apo çdo të drejte tjetër reale mbi to.

25.1. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi nuk përbën shkelje të tillë, që në kuptim të ligjit nr. 84/2016 të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, pasi kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e parë si adresë banimi.

25.2. Pas verifikimit të kursit zyrtar të këmbimit në kohën e deklarimit⁹ trupi gjykues i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit në lidhje me mospërputhjet në vlera të çmimit të pasurisë, duke përjashtuar këtu deklarimin e vitit 2004, në shumën 5,300,000 lekë, për të cilën vetë subjekti gjatë hetimit ka konfirmuar se e ka vendosur gabimisht atë.

⁷ Në datën 27.09.2004

⁸Ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive neni 6: “*Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbarin detyrimin për deklarim, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluarat, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre*”; Kodi Civil, në nenin 141 përcakton kuptimin e pasurisë “*Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale.*”

⁹ Referoju historikut të kurseve të këmbimit në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/ ku rezultoi se në përcaktimin e vlerës prej 4,904,287 lekë (ekuivalenti i shumës 34,000 USD deklaruar në “Vetting”), subjekti i është referuar kursit të këmbimit të dollarit, i cili në atë kohë ka qënë i përafërt me 144,2 lekë/USD.

25.3. Trupi gjykues, gjithashtu vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit mbi moskuptimin e drejtë të rolit të kredisë si burim krijimi të pasurisë. Siç rezulton nga hetimi, subjekti është përpjekur të referojë të gjitha burimet, por ka qenë i pasaktë në deklarin e burimit kryesor, hua e marrë nga PSHM për pagesën e çmimit të blerjes. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se këto pasaktësi nuk përbëjnë shkelje të tilla, që në kuptim të ligjit nr. 84/2016 të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

26. Pasuria e llojit “truall”, me sipërfaqe 226 m² në rrugën “*”, Tiranë.** Pasuri e vënë gjatë martesës. Origjina e pasurisë rrjedh nga kontrata e premtim shitjes në vitin 2003 (vlera totale 1.950.000 lekë), kontrata e shitblerjes përfundimtare të pasurisë në shtator 2013, si dhe kontrata e pjesëtimit të pasurisë të vitit 2016 midis bashkëshortit të subjektit z. P.S dhe vëllait të tij z. S.S. Vlera e blerjes në prill 2003 për pjesën e P.S ishte 1,000,000 lekë, ndërsa në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të blerjes është rivlerësuar në vlerën 5,763,275 lekë. Pjesa takuese 50% për secilin bashkëshort.

26.1 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhurat personale të të dy bashkëshortëve.

26.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Në deklarin fillestar të pasurisë, nuk deklarohet nga subjekti. Në DPV/2004 e ka deklaruar si tokë të pahipotekuar 175 m², blerë në vitin 2003, por pa deklaruar burimin e krijimit. Në vijim, në DPV/2013 ka deklaruar rivlerësimin e truallit dhe formalizuar kontrata e shitblerjes të truallit –1/2 e pjesës së truallit të blerë bashkë me S.S në shumën 5,763,275 lekë dhe në DPV/2016 është deklaruar kontrata e pjesëtimit midis P.S dhe vëllait të tij S.S, për truallin në pronësi të përbashkët të tyre mbi të cilën është ndërtuar shtëpia që është në proces legalizimi.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

26.3. Nga hetimi i kryer, ASHK Tiranë¹⁰ ka konfirmuar pronësinë mbi pasurinë “truall” me sipërfaqe 226 m², në emër të z. P.S. Nga administrimi i dokumentacionit¹¹, bashkëlidhur informacionit të ASHK-së, në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, kanë rezultuar këto fakte:

26.4. Në datën 14.4.2003, midis personit të lidhur P.S dhe trashëgimtarëve të familjes H, përfaqësuar me prokurë¹² nga z. S.H është lidhur kontrata për premtim shitje¹³, me objekt premtimin për shitje të një sipërfaqeje truallit prej 333 m², rruga “***”, në zonën kadastrale nr. ***, me çmim 1,950,000 lekë, çmim i cili mbetet i pandryshuar edhe në kohën e lidhjes së kontratës për kalimin e pronësisë.

26.5. Rezulton se pagesa është kryer me transfertë bankare nga Banka Amerikane e Shqipërisë në datën 15.4.2003, ku nga llogaria e z. S.S (vëllai i bashkëshortit të subjektit) është transferuar shuma 9,877 pound në favor të palës premtuese shitëse z. S.H, si përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve, i cili e ka tërhequr këtë shumë të konvertuar në 2,010,000 lekë.

26.6. Në datën 2.9.2013, midis shitësve, trashëgimtarëve të familjes H, përfaqësuar me prokurë të posaçme¹⁴ nga z. S.H dhe shtetasve P e S.S (vëllai tjetër i bashkëshortit të subjektit) në cilësinë e blerësve, është lidhur kontrata e shitblerjes¹⁵ për shitjen e një truallit me sipërfaqe prej 450 m², kundrejt çmimit 13,526,550¹⁶ lekë, shlyer plotësisht jashtë zyrës noteriale.

¹⁰ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2020, pasuri e regjistruar në datën 7.3.2016.

¹¹ Dokumentacioni është paraqitur gjithashtu nga subjekti gjatë deklarinëve në ILDKPI dhe në vijim i njëjti dokumentacion gjatë procesit të hetimit.

¹² Prokurë me nr. *** rep., dhe *** kol., datë 16.3.2002.

¹³ Kontrata premtim shitjeje me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁴ Prokurë me nr. *** rep., dhe *** kol., datë 18.11.2006.

¹⁵ Kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁶ Referuar kontratës është çmimi sipas rivlerësimit të bërë për këtë pasuri.

26.7. Në vijim, në datën 1.3.2016 midis bashkëpronarëve P.S dhe S.S është lidhur kontrata e pjesëtimit të pasurisë të paluajtshme, ku në emër të z. P.S figuron i regjistruar pasuria me sip. 226 m², me nr. *** pasurie, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***, ndërsa në emër të S.S figuron e regjistruar pjesa tjetër e pasurisë me sipërfaqe 224 m², me nr. *** pasurie, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***.

Në lidhje me çmimin dhe mënyrën e likuidimit të tij

A. Kontrata premtim shitjeje datë 14.4.2003

27. Në lidhje me vlerësimin mbi pagesën e çmimit të blerjes, Komisioni iu referua deklaramentit të subjektit, duke e krahasuar atë me parashikimin kontraktual.

27.1. Në DPV/2004, subjekti ka deklaruar: “*Tokë e pahipotekuar 175 m², blerë në 2003 pranë kodrës “***”, Tiranë. Vlera 1,000,000 lekë. Pjesa takuese 1/2. Viti i krijimit të pasurisë 2003...*”

27.2. Në kontratën e premtim shitjes të lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe trashëgimtarëve të familjes H, çmimi i përcaktuar në shumën 1,950,000 lekë, rezultoi se është paguar me transfertë bankare nga z. S.S, vëllai i bashkëshortit të subjektit.

27.3. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka sqaruar¹⁷ se kjo pagesë është kryer me të ardhurat e z. S.S, vëllait të tjetër të bashkëshortit, të cilët kishin rënë dakord me bashkëshortin e subjektit për blerjen e një trualli dhe ndërtimin e dy shtëpive më vete. Për të vërtetuar se z. S.S ka vepruar për llogari të vëllait tjetër S.S, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës *statement* nga banka “Intesa San Paolo” (ish-Banka Amerikane), nga ku rezultonte se pagesa 10,000 pound, nga e cila është kryer pagesa në datën 15.4.2003 për blerjen e pasurisë ndaj S.H, ka qenë gjendje në këtë llogari prej datës 3.6.2002, si rrjedhojë e një transferte në mbërritje nga jashtë bankës në këtë datë.

27.4. Në vijim, i pyetur nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se shumën prej 1,000,000 lekë si detyrim ndaj z. S.S, për pjesën e tij takuese, bashkëshorti e ka shlyer duke investuar në ndërtimin e themeleve/bodrumit, që i takonin pjesës së shtëpisë së z. S.S, duke qenë se në atë kohë ai jetonte në Mbretërinë e Bashkuar. Subjekti ka sqaruar se nuk disponon dokumente/fatura për blerjen e materialeve të ndërtimit dhe kryerjen e shërbimeve. Gjithashtu, ka shpjeguar¹⁸ se ndërtimi i themeleve dhe karabinave është kryer njëherazi për të dyja shtëpitë, duke filluar që nga viti 2003.

27.5. Pas analizës së fakteve nga hetimi administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa rezultoi se: **a)** subjekti nuk ka deklaruar pasurinë në deklaratën fillestare sipas ligjit nr. 9049/2003; **b)** ka mospërputhje në deklaramentimin e subjektit në DPV/2004 me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, në lidhje me sipërfaqen e deklaruar dhe vlerën e pasurisë; **c)** ka mospërputhje në deklaramentimet e subjektit me provat e administruara gjatë hetimit për burimin e krijimit, për arsye se në DPV/2004¹⁹ subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortëve ndërsa nga hetimi rezultuan *indicie* për përkatësi në interesat pasurorë mbi këtë pasuri nga: i) vjehri i subjektit z. H.S²⁰, ii) kunati i subjektit z. S.S²¹ dhe kunati tjetër z.

¹⁷ Në pyetësorin e parë.

¹⁸ Në përgjigje të pyetësorit të parë.

¹⁹ Viti kur ka deklaruar për herë të parë pasurinë.

²⁰ Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., dhe *** kol., datë 19.10.2006, të lëshuar nga z. P.S, është deklaruar se “*në kontratën premtim shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.04.2003 blerës i truallit figuroj unë por në të vërtetë gjysma e këtij trualli i përket babait tim H.S. Këtë fakt e deklaroj publikisht për çdo eventualitet.*”

²¹ I cili sipas kontratës për premtim shitje ka paguar çmimin.

S.S.²², e në këtë kuptim, duke u konsideruar si persona të tjerë të lidhur me subjektin, sipas nenit 3 pika 14 të ligjit nr. 84/2016, iu kërkua subjektit që në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 1,950,000 lekë nga z. S.S/S.S.²³.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare parashtrori, ndër të tjera, se në deklaratën periodike ka pasqyruar realisht sipërfaqen prej 117 m² dhe vlerën prej 1,000,000 lekë, si pjesë takuese e bashkëshortit të saj nga sipërfaqja e përbashkët prej 333 m² dhe vlerën prej 1,950,000 lekë me vëllain e tij z. S.S. Mosdeklarimi në deklaratën e parë ka ardhur për shkak të moskuptimit të të drejtave që duheshin deklaruar, gjë që është korrigjuar në DPV/2004.

28.1 Më tej, subjekti ka shpjeguar se ka qenë e qëndrueshme në lidhje me deklarin e mënyrës së pagesës për blerjen e këtij trualli me të ardhurat e vëllait të bashkëshortit z. S.S nga Mbretëria e Bashkuar, nëpërmjet transfertave bankare dërguar në llogarinë e vëllait tjetër z. S.S dhe për mënyrën e shlyerjes së pjesës takuese prej 1,000,000 lekë nga vlera totale prej 1,950,000 lekë. Ajo ka theksuar se familja e saj dhe familja e z. S.S kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të përballuar këtë blerje.

28.2. Për të provuar të ardhurat e përfituara nga z. S.S, për periudhën vjetore 2000-2004, subjekti paraqiti në cilësinë e provave akte jo në formën e kërkuar nga ligji: 1) akte në gjuhën angleze, emërtuar “*I.R.S.A-T.C*”, gjithsej 11 fletë; 2) fotokopje *statement* të llogarisë në pound në bankën “Intesa San Paolo”, të S.S, gjithsej 3 fletë, duke pretenduar se të ardhurat e siguruara nga z. S.S në Mbretërinë e Bashkuar janë transferuar në llogarinë e çelur në emër të z. S.S përgjatë viteve 2002 dhe 2003, në total në shumën 27,993 paund ose afërsisht 5,6 milionë lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

29. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në lidhje me çështjet e rezultuara nga hetimi administrativ, për sa i përket përfitimit të të drejtave reale mbi pasurinë “truall”, sipas kontratës për premtim shitjeje, vlerëson se:

a) subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte të drejtat reale të përfituara nga kontrata për premtim shitjeje e pasurisë “truall”, në zbatim të nenit 6²⁴ të ligjit nr. 9049/2003, por duke mbajtur parasysh DPV/2004 në të cilën referohet viti 2003 si krijim i pasurisë, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit mbi paqartësinë në deklarin për herë të parë. Si përfundim, mbetet një deklarin i pasaktë ndër vite, i cili nuk sjell penalizimin e subjektit në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

b) Në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve të subjektit për sipërfaqen e përfitur dhe vlerën e pasurisë “truall” në raport me aktet e administruara gjatë hetimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit sepse: i) bashkëshorti përfitoi i vetëm të drejta reale mbi pasurinë me sipërfaqe 333 m²; ii) në kontratën e premtim shitjes nuk rezultoi asnjë parashikim mbi bashkëpronësinë e bashkëshortit të subjektit me vëllain e tij z. S.S, në kuptim të rregullimit ligjor mbi bashkëpronësinë²⁵; iii) pretendimi i subjektit për pjesën

²² Për të cilin subjekti ka deklaruar në DPV/2013 si bashkëpronar në ½ pjesë takuese në këtë pasuri dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit e ka deklaruar si financues për blerjen e pasurisë.

²³ Z. H.S rezultoi nga hetimi se ka ndërruar jetë në datën 10.7.2013, sipas aktit të çeljes së trashëgimisë ligjore me vërtetimin nr. *** rep., *** kol., datë 25.3.2016.

²⁴ Neni 6, deklarimi i parë “*Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarin, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre*”.

²⁵ Dispozitat e Kodit Civil, titulli III “Bashkëpronësia”.

takuese duhet të ishte i bazuar në aktpjesëtim, i cili për sendet e paluajtshme është parashikuar të bëhet me akt noterial. Për këto arsye, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimet e subjektit në lidhje me pjesën takuese të bashkëshortit prej 117 m² dhe vlerën respektive të paguar në shumën 1,000,000 lekë, mbeten në nivel deklarativ.

c) Në lidhje me provueshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave për pagesën e çmimit, trupi gjykues vlerësoi se dokumentacioni i paraqitur për të ardhurat e z. S.S nuk mori vlerën e provës, për sa nuk u paraqit nga subjekti në formën e kërkuar nga ligji²⁶.

29.1. Rrjedhimisht, në analizën financiare, për pagesën e vlerës së truallit në vitin 2003 u konsideruan të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj, nga ku rezultoi se ata kanë pasur mundësi për të përballuar pagesën e shumës 1,950,000 lekë, si dhe për kryerjen e investimeve të tjera në vitin 2003, duke rezultuar me një balancë pozitive²⁷.

Në lidhje me kontratën e shitblerjes e datës 2.9.2013

30. Në DPV/2013, subjekti ka deklaruar: “...Rivlerësim të tokës ku është ndërtuar shtëpia në proces legalizimi dhe formalizuar kontrata e shitblerjes të truallit (fillimisht me kontratë parablerje) – 1/2 e pjesës së truallit të blerë bashkë me S.S, në shumën 5,763,275 lekë...”.

30.1. Nga hetimi i Komisionit²⁸ rezultoi se në datën 2.9.2013 është lidhur kontrata e shitblerjes midis trashëgimtarëve të familjes H (“shitësit”) si dhe z. P.S dhe S.S (“blerësit”), sipas të cilës është kaluar pronësia e pasurisë “truall” me sipërfaqe prej 450 m², me nr. *** pasurie, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 13,526,550 lekë. Sipas kësaj kontrate, shuma e mësipërme është paguar e plotë prej blerësve jashtë zyrës noteriale dhe se shitësit nuk kanë pretendime.

30.2. Nga analizimi i kësaj kontrate nuk u konstatua lidhja me kontratën premtim shitje të datës 14.4.2003, e cila parashikonte se çmimi në shumën 1,950,000 lekë për sipërfaqen e premtuar për shitje prej 333 m² nuk do të ndryshonte edhe në kohën e lidhjes së kontratës për kalimin e pronësisë. Pra, ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti, me kontratën e shitblerjes, shtetasit S rezultuan bashkëpronarë mbi një sipërfaqe truall më të madhe kundrejt një çmimi shumëfish më të lartë parashikuar në kontratën premtim shitje.

30.3. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë disa sqarime në lidhje me rrethanat e ndryshimit të sipërfaqes dhe çmimit për blerjen e tokës, duke e lidhur me investimin për sistemimin e saj i cili ishte i konsiderueshëm sipas subjektit (shumë më tepër seç ishte planifikuar) e në këtë mënyrë u negociua dhe dakordësua në mënyrë verbale me palën shitëse për shtimin me 117 m² të sipërfaqes së tokës që do të përdorej për ndërtimin, pa rritur çmimin e shitjes prej 1,950,000 lekë, në mënyrë që të vendoseshin dy shtëpi ngjitur me njëra – tjetrën, marrëveshje e cila u formalizua në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes së truallit në datën 2.9.2013 për sipërfaqen 450 m².

30.4. Në lidhje me çmimin e blerjes, subjekti ka sqaruar²⁹ se nuk ka paguar çmim tjetër përveçse vlerës 1,950,000 lekë dhe se çmimi i përdorur në kontratën e shitblerjes datë 2.9.2013

²⁶ Neni 266 i K.Pr.C “Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent; i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i apostiluar sipas ligjit nr. 9060/2003 “Për aderimin e RSH-së në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.

²⁷ Tabela financiare paraqitet më poshtë në tabelën 2 për efekt ekonomizimi të materialit, duke qenë se në të njëjtin vit, pra, në vitin 2003 subjekti fillon ndërtimin e shtëpisë.

²⁸ Aktet e depozituara në ASHK vënë në dispozicion me kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 16.6.2020 të ASHK-së.

²⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, bashkë me shpjegimet e datës 14.9.2020 të subjektit në KLP, si provë e paraqitur nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit.

në vlerën 13,526,550 lekë, është çmimi i referencës, i cili u përdor për rivlerësimin e truallit prej 450 m² nga shitësit në ZVRPP-në Tiranë, para se të përpilohej kontrata e shitblerjes për këtë truall. Për të provuar këto shpjegime, subjekti paraqiti në cilësinë e provës një deklaratë³⁰ lëshuar nga z. S.H, si përfaqësues me prokurë i familjarëve H, sipas së cilës, ka deklaruar ndër të tjera se ka marrë vetëm çmimin prej 1,950,000 lekësh, ndërsa çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes është çmimi i referencës së përdorur nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si detyrim ligjor. Gjithashtu ka konfirmuar se ka pasur marrëveshje verbale me vëllezërit S për rritjen e sipërfaqes së truallit për shkak të sistemimit të tokës, e cila është formalizuar në kontratën e shitblerjes së vitit 2013.

30.5. Shpjegimet e subjektit nuk rezultuan bindëse për sa nuk gjetën mbështetje në dokumentacionin ligjor të administruar nga Komisioni, për rrjedhojë u krye analiza financiare në datën e blerjes së pasurisë, duke u bazuar në deklarinimin e subjektit në vitin e blerjes mbi blerjen e truallit *1/2 e pjesës së truallit në shumën 5,763,275 lekë...*.

Tabela nr. 1.

	2.9.2013
A) PASURI	6,308,782
Truall me sipërfaqe 226 m ² , në rrugën “***”	5,763,275
Investim në shtëpinë private në rrugën “***” nr.*** Tiranë (sipas fazave të punimeve)	450,000
Ndryshim likuiditeti	95,507
B) DETYRIME	1,542,310
Kredi në euro pranë BKT-së	1,542,310
C) PASURI NETO (A-B)	4,766,472
D) TË ARDHURA	3,143,582
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës SR	21,600
Të ardhura nga paga SR	759,214
Të ardhura nga paga, bashkëshorti	2,362,768
E) SHPENZIME	1,785,603
Shpenzime jetike	370,912
Shpenzime për kredinë në euro pranë BKT-së	831,420
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	386,976
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	196,294
Balanca e fondeve (D-C-E)	-3,408,493

30.6. Nga analiza financiare, subjekti dhe personi i lidhur me të rezultuan në pamjaftueshmëri financiare në shumën prej -3,408,493 lekë për të përballuar investimin për blerjen e truallit në datën 2.9.2013.

30.7. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa dukej se: **a)** kishte mospërputhje në deklarinimet e subjektit në DPV/2013 dhe deklaratën “Vetting” me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me sipërfaqen dhe çmimin e pasurisë të përfutur; **b)** mbetej i dyshimtë fakti i përfitimit të një sipërfaqeje truallit prej 117 m² më tepër sa ishte përcaktuar në kontratën për premtim shitje, pa pagesë shtesë, në rrethanat kur: **i)** çmimi i referencës³¹ në vitin 2013 ishte në vlerën 30,059

³⁰ Deklaratë e thjeshtë me vërtetim nënshkrimi nr *** rep., datë 9.3.2020.

³¹ Përcaktuar me VKM-në nr. 187, datë 6.3.2013. Çmimi i ref. për vitin 2013 është 30,059 lekë/ m².

lekë/ m², pra, sa 5-fishi i çmimit të dakordësuar në kontratën e premtim shitjes³²; ii) vetë pala shitëse ka paguar shpenzimet e rivlerësimit të truallit; iii) në kontratën e premtim shitjes ishte përcaktuar se çmimi do të ishte i pandryshueshëm vetëm për sipërfaqen 333 m² dhe nuk parashikohej rregullim tjetër në lidhje me sipërfaqen shtesë, që mund të përfitonte pala blerëse në vijim; c) nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në datën e blerjes së pasurisë subjekti dhe personi i lidhur me të rezultoi se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar me burime të ligjshme vlerën 5,763,275 lekë, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën prej -3,408,493 lekë për të përballuar blerjen e pasurisë në datën e blerjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

31. Subjekti në shpjegimet përfundimtare ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikundër gjatë hetimit administrativ, duke theksuar se pasuria “truall” me sipërfaqe prej 450 m² e blerë në vitin 2013 është e njëjta pasuri me atë të premtuar për shitje në vitin 2003, me sipërfaqe prej 333 m². Rritja e sipërfaqes prej 117 m² ka ardhur si rezultat i sistemimit të truallit, që me nisjen e themeleve në vitin 2003, i cili prodhoi kosto të konsiderueshme (shumë më tepër seç ishte planifikuar) dhe për këtë pati dakordësi verbale me palën shitëse, që kur të formalizohej kontrata e shitjes, të përfshihej sipërfaqja e shtuar pa rritur çmimin.

31.1. Subjekti ka theksuar se çmimi i shitblerjes nuk ka ndryshuar, pavarësisht rritjes së sipërfaqes, pasi ky fakt ka qenë i parashikuar në kontratën e premtim shitjes e në rast të kundërt do të zbatoheshin sanksione kundrejt shitësve. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë noteriale³³, lëshuar nga përfaqësuesi i shitësve, z. S.H, i cili ka konfirmuar të njëjtat rrethana si subjekti i rivlerësimit për rritjen e sipërfaqes së truallit prej 117 m² dhe se çmimi i shitjes i paguar ka qenë vetëm ai në shumën prej 1,950,000 lekësh.

31.2. Subjekti, në shpjegimet e saj, më tej arsyetoi se pozicionimi i themeleve të shtëpisë është i njëjti nga viti 2004 dhe ndërtimi i shtëpisë nuk ka ndryshuar që atëherë e deri aktualisht, duke paraqitur në cilësinë e provës një aktekspertimi teknik të datës 16.7.2021.

31.3. Çmimi i vendosur në kontratë është çmimi i rivlerësimit, i bazuar në VKM-në nr. 187, datë 6.3.2013, të cilin noteri ishte i detyruar ta vendoste sipas udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar. Subjekti, gjithashtu ka shpjeguar se të gjitha kostot/taksat për rivlerësimin dhe regjistrimin e tij janë paguar nga vëllezërit S, duke paraqitur si prova 3 mandatpagesa³⁴ të kryera në favor të ZVRPP-së nga personi i lidhur P.S, si dhe aktin e llogaritjes për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

31.4. Në lidhje me analizën financiare, subjekti pretendoi se mund të përfshihej vlera e truallit e shtuar prej 117 m², e paguar prej saj, nëse në rastin hipotetik konsiderohet sipërfaqja e shtuar, duke e llogaritur me çmimin e rivlerësuar prej 30,059 m², e cila në total në pjesë takuese të bashkëshortit arrin në shumën 2,303,959 lekë. Subjekti pretendoi se në analizën financiare të datës së blerjes duhet të përfshihen edhe të ardhurat e përfituara nga ajo në cilësinë e ekspertës gjatë vitit 2013, të cilat edhe pse janë harruar të deklarohen në “Vetting”, janë deklaruar në DPV/2013. Më konkretisht shuma 59,400 lekë, përfituar në maj 2013 dhe shuma 1,489 USD ose konvertuar në vlerën 160,812 lekë, përfituar po në muajin maj 2013. Sipas subjektit, nëse analiza financiare në datën e blerjes do të bëhej duke përfshirë këto të dhëna, do të rezultonte se ajo dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar blerjen e pasurisë. Subjekti, paraqiti në cilësinë e provave, përveç sa cituar më lart, edhe disa akte të tjera³⁵. Në

³² Çmimi është afërsisht 6000 lekë/m² referuar çmimit të përcaktuar në kontratën për premtim shitjeje.

³³ Deklaratë me nr. *** rep., nr. *** kol.

³⁴ Nga këto, 2 mandate mbajnë datën 24.7.2013, ndërsa tjetri mban datën 7.8.2013.

³⁵ a) dy kontrata shërbimi, të paraqitura në gjuhën angleze, përkatësisht kontratë shërbimi, origjinale, datë 9.5.2013 (gjithsej 4 fletë) e lidhur me shoqërinë “Ch” për të ardhurat e pretenduara në vlerën 59,400 lekë dhe

përfundim, subjekti ka theksuar se ka qenë e qëndrueshme në deklaratimet e kryera ndër vite duke pasqyruar realisht sipërfaqen si pjesë takuese e bashkëshortit të saj dhe vlerën e paguar për të.

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

32. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet përfundimtare të paraqitura nga subjekti, ato të relatuara në seancën dëgjimore dhe pas administrimit të provave të paraqitura në mbështetje të tyre, vlerëson se:

32.1. Nga analizimi i shpjegimeve të subjektit për këtë pasuri duket qartë qëndrueshmëria e subjektit për të pasqyruar në çdo fazë të hetimit e deri në seancën dëgjimore gjendjen reale të të drejtave të pretenduara, porse këto deklarime nuk përputhen me dokumentacionin ligjor, administruar nga Komisioni. Trupi gjykues, në zbatim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e bazon vendimmarrjen në dokumentacionin ligjor të marrë nga burime të njohura. Në këtë kuptim, vlerë provuese për përfitimin e pasurisë merr akti noterial kontratë shitblerjeje me nr. *** rep. dhe nr. *** kol. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, blerësit z. P dhe z. S.S kanë përfituar si bashkëpronarë “tokë truall” me sipërfaqe 450 m², në datën 2.9.2013, kundrejt çmimit 13,526,550 lekë, çmim i cili është paguar i plotë nga blerësit dhe se shitësit nuk kanë ndonjë pretendim në lidhje me të.

32.3. Në analizë të kësaj dispozite, rezulton se palët janë angazhuar për të rregulluar pagesën e çmimit prej 13,526,550 lekë si të shlyer, me qëllimin e vetëm krijimin e garancive për gëzimin e qetë të pasurisë në të ardhmen. Nëse do të ishte e kundërta sikurse pretendon subjekti palët nuk kishin arsye të angazhoheshin nën një rregullim të tillë ligjor. Nuk rezultoi nga hetimi dhe as subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e shfuqizimit të kësaj dispozite kontraktuale me fuqi ligjore për palët.

32.4. Pretendimi i subjektit se ka patur mirëkuptimin e blerësve që në kohën e blerjes sipas kontratës premtim shitje për rritjen e sipërfaqes së truallit me 117 m² pa ndryshuar çmimin, mirëkuptim i cili është formalizuar në kontratën e shitblerjes, nuk gjen mbështetje në dokumentacionin ligjor, për arsye se në asnjë nga kontratat e cituara nga subjekti nuk rezulton lidhja me tyre. Për më tepër, në kontratën e shitblerjes nuk referohet kontrata premtim shitje për rregullimin e sipërfaqes së shtuar prej 117 m². Deklaratat noteriale³⁶ të z. S.H, të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në përfundim të tij, për të provuar vullnetin e shitësve, në lidhje me rrethanat e shitjes së pasurisë truall, për trupin gjykues kanë vlerë të kufizuar provuese dhe duket se përfaqësojnë përpjekjet e subjektit për të mbështetur shpjegimet e saj në lidhje me përfitimin e pasurisë prej 450 m² (në pjesën takuese të saj) kundrejt asnjë çmimi të paguar për të.

kontratë shërbimi, fotokopje, e lidhur me palën kontraktuese “T.L.B.G” për të ardhurat e pretenduara në vlerën 1,489 USD, si dhe dy akte “nxjerje llogarie”, fotokopje, lëshuar nga “Credins Bank” të datës 23.12.2019 për të provuar të ardhurat e përfituara nga këto kontrata shërbimi; b) shkresë me nr. *** prot., datë 14.7.2021³⁵ e lëshuar nga Prokuroria e Tiranës për të provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur konflikt interesi me shitësit; c) akteksptimi teknik i datës 16.7.2021; ç) dokumentacion mbi të ardhurat e familjarëve, pjesë e trungut me z. S.S: shkresë me nr. *** prot., datë 9.7.2021, lëshuar nga Banka e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat e rezultuara për z. S.S, punonjës i këtij institucioni për periudhën mars 2006-dhjetor 2013 (gjithsej 4 fletë), vërtetim me nr. *** prot., datë 7.7.2021 lëshuar nga BKT-ja, në lidhje me të ardhurat e rezultuara për znj.E.S, punonjëse e këtij institucioni për periudhën janar 2005-30 qershor 2021 (gjithsej 4 fletë), vërtetim me nr. *** prot., datë 7.7.2021 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë e ISSH-së në lidhje me të ardhurat në formën e pensionit të pleqërisë për z. H.S për periudhën janar 2003-korrik 2013 dhe zj. A.S për periudhën janar 2003-shkurt 2014 (gjithsej 3 fletë); dy certifikata familjare të z. S.S datë 9.7.2021 sipas gjëndjes së trungut familjar të datës 18.2.2005 dhe aktualisht.

³⁶ Deklaratë datë 7.3.2020, me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 9.3.2020 dhe deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2021 nga z. S.H si përfaqësues i shitësve.

32.5. Trupi gjykues vlerëson, gjithashtu se, pretendimi i subjektit në lidhje me shtimin e sipërfaqes prej 117 m², pa ndryshuar çmimin për shkak të kostove shtesë të paparashikuara gjatë sistemit të tokës në vitin 2003, mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar për sa subjekti nuk i ka deklaruar këto rrethana në deklaratën periodike të kohës kur janë kryer, si dhe nuk rezultuan të parashikuara as në kontratën e shitblerjes të lidhur midis palëve. Akti i ekspertimit teknik i datës 16.7.2021 i përgatitur nga eksperti i caktuar nga subjekti, përfaqëson një mendim teknik në lidhje me vlerësimin gjeodezik të sipërfaqes së truallit në retrospektivë; në vitin 2003 që lidhet me kontratën premtim shitjeje dhe në vitin 2013 me kontratën e shitblerjes, por ky akt nuk provon vullnetin ligjor të palëve për të rregulluar kushtet për përfitimin e pasurisë sikurse pretendon subjekti.

32.6. Në lidhje me pretendimin se çmimi i përcaktuar në kontratë është çmimi i rivlerësimit dhe se nuk e ka paguar asnjëherë këtë çmim, duke arsyetuar se është vendosur nga noteri si çmim i detyruar bazuar në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, duke patur dakordësinë e palëve, trupi gjykues vlerëson të ndalojë për të arsyetuar se, në kohën e hartimit të kontratës së shitblerjes së datës 2.9.2013 ka qenë në fuqi VKM-ja nr. 187, datë 6.3.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark në Republikën e Shqipërisë”. Referuar këtij akti nënligjor, vlera mesatare e pasurisë në zonën kadastrale ku është regjistruar ka qenë 30,059 lekë/m², e cila për sipërfaqen totale prej 450 m² arrin në shumën 13,526,550 lekë, pra, sa çmimi i shitblerjes. Trupi gjykues nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti³⁷ konstaton se mbi bazën e kësaj VKM-je është kryer dhe rivlerësimi i pasurisë përpara shitblerjes nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim që shitësi të ishte sa më afër vlerës së tregut për pasurinë që do të shiste, por rivlerësimi i kryer nuk provon se për shitjen e kësaj pasurie nuk është paguar çmim për sa vetë palët i kanë dhënë shumës prej 13,526,550 lekë vlerën e çmimit kontraktual të shitblerjes.

32.7. Në lidhje me përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të përfituara nga subjekti në cilësinë e ekspertes në maj 2013, trupi gjykues, pas administrimit të dokumentacionit, vlerëson se të ardhurat e përfituara nga shoqëritë “Ch.I” dhe “L.B.G”, nuk mund të konsiderohen në analizën financiare, pasi subjekti nuk arriti të paraqiste provat në formën e kërkuar nga ligji, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuara me origjinalin. Trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim në lidhje me këto të ardhura, pavarësisht konstatimit të transfertave bankare³⁸ në favor të subjektit, për sa nuk provohet nëse mbi to janë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

32.8. Për sa më lart, si dhe bazuar në nenin 690 të Kodit Civil, sipas të cilit kontrata e lidhur ka forcën e ligjit për palët, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me blerjen e pasurisë truall prej 450 m² (në pjesën takuese) pa paguar asnjë çmim për të, se nuk u provuan deklaratimet e subjektit në lidhje me përfitimin e një sipërfaqe truall shtesë prej 117 m² kundrejt të njëjtit çmim të paguar më parë në kontratën premtim shitjeje, e për rrjedhojë analiza financiare e subjektit mbetet e njëjta.

32.9. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej - 3,408,493 lekësh për të përballuar blerjen e pasurisë “truall” në datën 2.9.2013. Për këto arsye, subjekti është në kushtet e aplikimit të masës disiplinore shkarkim nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33 pika “b” të ligjit nr. 84/2016.

³⁷ Dokumentacioni për aplikimin dhe pagesën për rivlerësimin pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë.

³⁸ Nga hetimi u evidentuan 2 kalime referuar ekstraktit të llogarive dërguar nga “Credins Bank” me shkresën nr. ***, datë 17.8.2020.

33. Shtëpi private banimi me sipërfaqe 190 m² (2 kate mbi tokë) + 85 m² (kat në papafingo) + 85 m² (bodrum), e ndërtuar mbi truallin e mësipërm në rrugën “***”, Tiranë, në proces legalizimi.

33.1. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kredi të marra në Bankën Kombëtare Tregtare dhe në “PSHM” dhe të ardhurat personale të dy bashkëshortëve. Ndërtimi i shtëpisë ka filluar nga viti 2003 dhe ka vazhduar deri në vitin 2013, ndërkohë që është bërë e banueshme që në korrik të vitit 2009. Vlera e investuar nga viti 2003 deri në 2016 është 15, 000,000 lekë. Pjesa takuese 50% për secilin bashkëshort.

33.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: subjekti ka kryer deklarim për fazat e ndërtimit, si dhe shpenzimet e tjera duke filluar nga viti 2004. Në DPV/2004, subjekti ka deklaruar: “...*Karabina shtëpie mbi tokën më lart. Vlera 3,000,000 lekë. Pjesa takuese 1/2. Viti i krijimit të pasurisë 2003....*”. Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar: “...*Investime në bërjen e çatisë në shtëpinë private të deklaruar më parë. Shuma 750,000 lekë....*”. Në DPV/2008 subjekti ka deklaruar: “...*Investime në shtëpinë private, të deklaruar më parë në ndërtim shuma 5,500,000 lekë...*”. Në DPV/2009 subjekti ka deklaruar: “...*Investime në shtëpi private të deklaruar më parë në ndërtim në shumën 2,500,000 lekë...*” si dhe shpenzime mobilimi “*Paisje shtëpie (kolltuqe, televizor, kuzhinë, lavatriçe etj) në shumën 1,500,000 lekë.*”. Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar: “...*Investime në shtëpi private deklaruar më parë në shumën 700,000 lekë....*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

34. Nga hetimi³⁹ i kryer në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar se ndërtesa ka filluar të legalizohet në datën 8.11.2006 mbi bazën e vetëdeklarimeve të z. P.S⁴⁰ dhe H.S, ku në vijim, pas procedurave të kryera, në datën 17.5.2017 është lëshuar leja e legalizimit nga ALUIZNI⁴¹ në favor të P.H.S dhe S.H.S, për godinën 3 katëshe + 1 kat nën tokë, e cila është regjistruar në ASHK (në atë kohë ZVRPP-ja) Tiranë, në datën 20.9.2019 me numër pasurie *** ND, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***, në emër të dy bashkëpronarëve P.H.S dhe S.H.S.

Analiza financiare e investimeve të kryera sipas 7 fazave të ndërtimit me burimet e deklaruara

34.1. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se ndërtimi i shtëpisë ka filluar nga viti 2003 deri në vitin 2013 dhe se vlera e investuar nga viti 2003 deri në 2016 është 15.000.000 lekë.

34.2. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: i) kredi të marra në Bankën Kombëtare Tregtare dhe në PSHM, ii) të ardhurat personale të dy bashkëshortëve.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për fazën e parë dhe të dytë të investimit (2003-2004)

34.3. Në DPV/2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “...*Karabina shtëpie mbi tokën më lart. Vlera 3,000,000 lekë. Pjesa takuese 1/2. Viti i krijimit të pasurisë 2003....*”, ndërsa në seksionin e detyrimeve ka deklaruar: “*Kredi në shumën 40,000 Euro për blerje apartamenti dhe ndërtim për 15 vjet me interes 6.4%. Kontrata e lidhur në shtator 2004. Banka BKT. Janë shlyer 2 këste. Shuma e detyrimit të mbetur 40,000 euro.*”

34.4. Në përgjigje të pyetësorit⁴² të Komisionit, subjekti ka sqaruar në lidhje me investimet e kryera përkatësisht për vitet 2003 dhe 2004 që në total arrijnë shumën 3,000,000 lekë, duke theksuar se për vitin 2003 ka investuar për sistemimin e tokës, bërjen e themeleve së shtëpisë

³⁹ Kthim përgjigjeje ASHK-ja nr. *** prot., datë 16.6.2020.

⁴⁰ Ku ka nënshkruar edhe subjekti i rivlerësimit.

⁴¹ Leje legalizimi me nr. ***.

⁴² Shih pyetësorin nr. 2.

dhe fillimin e karabinasë në shumën 1,200,000 lekë, me burim nga të ardhurat nga kursimet e viteve të mëparshme, nga paga e Magjistraturës dhe të ardhurat nga pagat neto gjatë vitit 2003, e duke vijuar për vitin 2004 ku ka sqaruar se ka investuar në vazhdimin e karabinasë në shumën 1,800,000 lekë me burim nga pagat neto të vitit 2004 dhe fonde nga kredia e BKT-së në vitin 2004.

34.5. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2003

Analiza për mundësitë financiare të investimit për fazën e parë në vitin 2003

Tabela nr. 2.

	2003
A) PASURI	3,155,873
Truall me sipërfaqe 333 m ² , në rrugën “****”	1,950,000
Investimi në shtëpinë private në rrugën “****” nr. ***, Tiranë (sipas fazave të punimeve)	1,200,000
Ndryshim likuiditeti	5,873
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	3,155,873
D) TË ARDHURA	6,701,408
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, SR, viti 2003	239,420
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, SR, viti 2001-2002	351,240
Të ardhura nga paga, SR, viti 2003	61,600
Të ardhura nga paga, bashkëshorti, viti 2003	1,832,455
Të ardhura nga paga bashkëshorti, vitet 1999-2002	4,216,693
E) SHPENZIME	2,232,455
Shpenzime jetike për vitin 2003	281,592
Shpenzime jetike për vitet 1999-2002	854,501
Shpenzime për qiranë/këstet për apartamentin 71,5 m ² në rrugën “****”, për vitin 2003	292,159
Shpenzime për qiranë/këstet për apartamentin 71,5 m ² në rrugën “****”, vitet 2001-2002	493,140
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	293,463
Shpenzime udhëtimi SR, Tiranë - Kavajë - Tiranë	17,600
Balanca e Fondeve (D-C-E)	1,313,080

34.6. Në përfundim të analizës financiare rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të investuar në shumën 1,200,000 lekë përgjatë vitit 2003.

34.7. Në lidhje me mosdeklarimin e të drejtave reale të përdorimit të truallit për fillimin e ndërtimit në deklaratën e parë të vitit 2003, ashtu sikurse konstatohet edhe për pasurinë “truall”, trupi gjykues, pas shpjegimeve konsistente të dhëna nga subjekti në lidhje me të dyja pasuritë i vlerëson ato bindëse, bazuar në parimin e proporcionalitetit, për sa subjekti i ka deklaruar ato një vit më vonë, pra, në DPV/2004.

34.8. Në lidhje me fazën e dytë të investimit në vitin 2004, sikurse përmendur më lart subjekti ka sqaruar se për kryerjen e investimit për karabinanë ka përdorur të ardhurat nga pagat dhe kredi të marrë në BKT po në këtë vit.

34.9. Nga hetimi bankar, BKT⁴³, konfirmon se z. P.S ka lidhur një kontratë kredie në datë 9.9.2004 për një kredi në shumën 40,000 euro me qëllim blerje apartamenti. Kjo kredi është disbursuar në datën 30.9.2004, ku një pjesë e kredisë në shumën 24,837 euro (ekuiv. 30,500 USD), është përdorur nga z. S për mbylljen e huasë në PSHM, trajtuar tek pasuria e parë apartament 75 m², ndërsa shuma e mbetur nga kredia rezulton se është përdorur për investimin e shtëpisë së banimit, sikurse vetë subjekti ka sqaruar përgjatë hetimit administrativ si dhe deklaruar në “Vetting”.

34.10. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u përgatit analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2004.

Analiza për mundësinë financiare të investimit për fazën e dytë të ndërtimit në vitin 2004

Tabela nr. 3.

	2004
A) PASURI	5,855,369
Apartament banimi me sip 71.5 m ² , në rrugën “****” pranë “****”.	2,914,483
Investimi në shtëpinë private në rrugën “****” nr. *** Tiranë (sipas fazave të punimeve)	1,800,000
Automjet “Mercedes-Benz” me targë TR *** I	430,000
Ndryshim likuiditeti	710,886
B) DETYRIME	5,408,904
Kredi pranë Institucionit financiar jo bankë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	390,000
Kredi në euro pranë BKT-së	5,018,904
C) PASURI NETO (A-B)	446,465
D) TË ARDHURA	2,775,058
Të ardhura nga paga, SR	774,000
Të ardhura nga paga bashkëshorti	1,994,329
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	6,729
E) SHPENZIME	800,362
Shpenzime jetike	281,592
Shpenzime për qiranë/këstet për apartamentin 71,5 m ² në Rr. ***	190,673
Shpenzime për kredinë pranë BKT EURO	88,211
Shpenzime për kredinë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	153,990
Shpenzime udhëtimi Tiranë - Kavajë - Tiranë	35,200
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	50,696
Balanca e Fondeve (D-C-E)	1,528,231

⁴³ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.9.2004; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 26.5.2020 nga BKT, pjesa ***, faqe ***.

34.11. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë patur mundësi financiare me burime të ligjshme për të investuar në shumën 1,800,000 lekë përgjatë vitit 2004.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për fazën e tretë të punimeve, vendosjen e çatisë në vitin 2006

35. Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar:”...Investim në bërjen e çatisë në shtëpinë private të deklaruar më parë. Shuma 750,000 lekë...”, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Gjatë hetimit administrativ⁴⁴, subjekti ka deklaruar si burim për investimin e kryer të ardhurat nga pagat e subjektit dhe personit të lidhur.

35.1. Në shpjegimet përfundimtare, sikurse kërkuar nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se burim krijimi ka qenë kredia e marrë nga PSHM, e cila është deklaruar në DPV/2006. Trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare të kryer për vitin 2006 është përfshirë edhe kredia e marrë nga PSHM, deklaruar nga subjekti në rubrikën e detyrimeve financiare.

35.2. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2006.

Tabela nr. 4.

	2006
A) PASURI	777,866
Shtëpi private në rrugën “****” nr. ***, Tiranë (sipas fazave të punimeve)	750,000
Ndryshim likuiditeti	27,866
TOTAL LIKUIDITETE	234,547
B) DETYRIME	859,000
Kredi pranë institucioneve financiare jo bankë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	859,000
C) PASURI NETO (A-B)	-81,134
D) TË ARDHURA	3,131,450
Të ardhura nga paga, SR	169,339
Të ardhura nga paga, bashkëshorti	2,636,414
Të ardhura nga ISSH (leje lindjeje)	325,697
E) SHPENZIME	1,875,663
Shpenzime jetike	410,839
Shpenzime mobilimi / mirëmbajtje apartamenti, rruga “****”	70,000
Shpenzime për kreditë në euro pranë BKT-së	477,617
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	917,207
Balanca e fondeve (D-C-E)	1,336,921

⁴⁴ Në përgjigje të pyetësorit të dytë.

35.3. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të investuar për ngritjen e çatisë në shumën 750,000 lekë, në vitin 2006.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për fazën e katërt të investimit (rifinitura) në vitin 2008

36. Në DPV/2008 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “...investime në shtëpinë private, të deklaruar më parë në ndërtim shuma 5,500,000 lekë...”.

36.1. Gjatë hetimit administrativ⁴⁵, subjekti ka deklaruar se burimet për investimin e kryer në këtë fazë punimesh në vlerën 5,500,000 lekë, kanë qenë kredia prej 35,000 euro pranë BKT-së, kredia prej 2,500,000 lekësh në PSHM dhe të ardhurat nga pagat e dy bashkëshortëve, kredi të cilat janë deklaruar edhe në DPV/2008 në seksionin e detyrimeve financiare.

36.2. Nga hetimi bankar, BKT-ja⁴⁶ ka konfirmuar se në datë 14.04.2008 subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë kredie me BKT për një kredi në shumën 35,000 euro me qëllim ndërtim shtëpie, e cila është disbursuar në dt 25.04.2008 dhe kjo shumë është tërhequr me pjesë, në cash, nga personi i lidhur gjatë të njëjtit vit, ndërsa një pjesë prej 678,000 lekë është lënë gjendje në llogari në fund të atij viti.

36.3. Institucioni financiar NOA (ish-PSHM)⁴⁷, konfirmon se në datë 14.11.2008 është disbursuar një kredi në shumën 2,500,000 lekë dhe kjo shumë është tërhequr cash në pjesë gjatë të njëjtit vit, ndërsa shuma prej 1,000,000 lekë është vendosur depozitë dhe është tërhequr në vitin pasardhës.

36.4. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2008.

Tabela nr. 5.

	2008
A) PASURI	6,972,783
Shtëpi private në rrugën “****” nr. ***, Tiranë (sipas fazave të punimeve)	5,500,000
Ndryshim likuiditeti	1,472,783
TOTAL LIKUIDITETE	1,705,322
B) DETYRIME	6,811,388
Kredi pranë institucioneve financiare jo bankë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	2,500,000
Kredi në euro pranë BKT-së	4,311,388
C) PASURI NETO (A-B)	161,396
D) TË ARDHURA	4,323,423
Të ardhura nga paga, SR	803,601
Të ardhura nga paga, bashkëshorti	3,219,822
Të ardhura nga shitja e automjetit “Mercedes- Benz” me targë TR***I	300,000

⁴⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁴⁶ Kontrata nr.*** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2008; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 26.5.2020 nga BKT, pjesa ***, faqe ***.

⁴⁷ Kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 16.4.2021; shkresë me nr. *** prot., datë 11.5.2021 nga NOA.

E) SHPENZIME	2,234,381
Shpenzime jetike	546,480
Shpenzime për kredinë në euro pranë BKT-së	795,020
Shpenzime për kredinë pranë “Tirana Bank”	171,700
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	480,975
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	240,206
Balanca e fondeve (D-C-E)	1,927,647

36.5. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të investuar për rifiniturën në shumën 5,500,000 në vitin 2008.

Analiza e të ardhurave të deklaruar si burim krijimi për fazën e pestë të investimit (rifinitura) në vitin 2009

37. Në DPV/2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “...Investime në shtëpi private të deklaruar më parë në ndërtim në shumën 2,500,000 lekë...” si dhe “...Paisje shtëpie (kolltuqe, televizor, kuzhinë, lavatriçe etj) në shumën 1,500,000 lekë...”.

37.1. Gjatë hetimit administrativ⁴⁸, subjekti ka deklaruar se burimi i përdorur për investimin e kryer në këtë fazë punimesh në vlerën 2,500,000 lekë, ka shërbyer kredia prej 2,000,000 lekë e marrë pranë BKT-së dhe të ardhurat nga pagat e dy bashkëshortëve, kredi e cila është deklaruar edhe në DPV/2009 në seksionin e detyrimeve financiare.

37.2. Nga hetimi i kryer, BKT-ja⁴⁹ konfirmon se në datën 24.03.2009 subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë kredie me BKT-në për një kredi në shumën 2,000,000 lekë, me qëllim ndërtim shtëpie, e cila është disbursuar në datën 30.3.2009 dhe kjo shumë është tërhequr me pjesë, *cash*, nga personi i lidhur gjatë të njëjtit vit.

37.3. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2009.

Tabela nr. 6.

	2009
A) PASURI	936,992
Shtëpi private në rrugën “****” nr. *** Tiranë (sipas fazave të punimeve)	2,500,000
Ndryshim likuiditeti	-1,563,008
TOTAL LIKUIDITETE	142,314
B) DETYRIME	2,861,662
Kredi pranë institucioneve financiare jo bankë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	881,662
Kredi në lekë pranë BKT-së	1,980,000
C) PASURI NETO (A-B)	-1,924,670
D) TË ARDHURA	4,640,694
Të ardhura nga paga, SR	778,974
Të ardhura nga paga bashkëshorti, pas vitit 2002	3,856,364
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	5,356

⁴⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.
Shkresë me nr.*** prot., datë 22.5.2020.

E) SHPENZIME	4,497,335
Shpenzime jetike pas 2002	546,480
Shpenzime mobilimi shtëpia private, rruga “****” nr. ***	1,690,000
Shpenzime për kreditë në euro pranë BKT-së	966,225
Shpenzime për kreditë në lekë pranë BKT-së	206,519
Shpenzime për kreditë pranë “Tirana Bank”	174,450
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	899,944
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	13,717
Balanca e fondeve (D-C-E)	2,068,028

37.4. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të investuar për kryerjen e investimeve të deklaruara në vitin 2009.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për fazën e gjashtë të investimit (rifinitura) në vitin 2010

38. Në DPV/2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “...Investime në shtëpi private deklaruar më parë në shumën 700,000 lekë...”, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për investimin e kryer. Gjatë hetimit administrativ⁵⁰, subjekti ka deklaruar se burimi i përdorur për investimin e kryer në këtë fazë punimesh në vlerën 700,000 lekë, kanë qenë të ardhurat nga pagat e dy bashkëshortëve.

38.1. Në shpjegimet përfundimtare, sikurse kërkuar nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se burim krijimi ka qenë kredia shtesë e marrë nga BKT-ja, për qëllime të investimit të shtëpisë e cila është deklaruar në DPV/2010. Trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare të kryer për vitin 2010 është përfshirë edhe kredia e marrë nga BKT-ja, deklaruar nga subjekti në rubrikën e detyrimeve financiare.

38.2. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2010.

Tabela nr. 7.

	2010
A) PASURI	648,409
Shtëpi private në rrugën “****” nr. ***, Tiranë (sipas fazave të punimeve)	700,000
Ndryshim likuiditeti	-51,591
TOTAL LIKUIDITETE	90,723
B) DETYRIME	11,112,157
Kredi në euro pranë BKT-së	11,112,157
	-
C) PASURI NETO (A-B)	10,463,748
D) TË ARDHURA	4,592,372
Të ardhura nga paga, SR	1,032,128
Të ardhura nga paga, bashkëshorti	3,560,244

⁵⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

E) SHPENZIME	13,326,329
Shpenzime jetike	546,480
Shpenzime për kreditë në euro pranë BKT-së	9,402,157
Shpenzime për kreditë në lekë pranë BKT-së	2,175,108
Shpenzime për kreditë pranë “Tirana Bank”	174,300
Shpenzime <i>overdraft</i> pranë “Bankës Credins”	21,762
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	916,296
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	90,227
Analiza Financiare (D-C-E)	1,729,791

38.3. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të investuar për kryerjen e investimeve të deklaruara në vitin 2010.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për fazën e shtatë të investimit (rregullime në çati, papafingo) në vitin 2013

39. Në DPV/2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investime në ndërtim, por referuar seksionit “Detyrime ndaj personave juridikë apo fizikë”, subjekti ka deklaruar kredi për shtëpi në BKT, në shumën 11,000 euro, me afat 12 vjet, interes 5.5%, data e dhënies 17.5.2013, shuma e shlyer 715 euro dhe gjendje detyrimi 10,650 euro.

39.1. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se ndërtimi i shtëpisë ka zgjatur në periudhën 2003-2013. Më tej, gjatë hetimit administrativ⁵¹, subjekti ka sqaruar se ndër vite ka patur edhe shpenzime të tjera⁵², të cilat nuk janë deklaruar pasi kanë qenë nën pragun e deklarimit të shpenzimeve, duke referuar ndër të tjera edhe vitin 2013, ku shpenzimet sipas subjektit kanë qenë në shumën 450,000 lekë.

39.2. Nga hetimi bankar⁵³, BKT konfirmon se në datë 23.04.2013 subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë kredie me BKT për një kredi në shumën 11,000 euro me qëllim rregullim shtëpie, e cila është disbursuar në datën 27.5.2013 dhe kjo shumë është tërhequr me pjesë, *cash*, nga personi i lidhur gjatë të njëjtit vit.

39.3. Referuar dokumentacionit bankar të administruar, deklarimeve të subjektit, preventivit të paraqitur nga subjekti⁵⁴ pranë BKT-së, datë 18.12.2012, për punimet që do të kryheshin në papafingon e pasurisë objekt vlerësimi, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit mbi investimin e kryer në këtë vit në vlerën rreth 450,000 lekë.

39.4. Bazuar në deklarimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në vitin 2013.

⁵¹ Në përgjigje të pyetësorit të dytë.

⁵² Shpenzimet e tjera të deklaruara nga subjekti në pyetësorin standard dhe të dytin, të cilët kanë qenë nën pragun e deklarimit të shpenzimeve janë përfshirë në analizën financiare të vitit përkatës.

⁵³Kontrata nr. *** rep., nr *** kol., datë 24.3.2009; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 26.5.2020 nga BKT, pjesa *** faqe ***.

⁵⁴ Dosja e ILDKPKI-së, aneksi ***, faqe ***.

Tabela nr. 8.

	2013
A) PASURI	6,630,814
Truall me sipërfaqe 226 m ² në rrugën “****”	5,763,275
Shtëpi private në rrugën “****” nr. ***, Tiranë (sipas fazave të punimeve)	450,000
Ndryshim likuiditeti	417,539
B) DETYRIME	1,542,310
Kredi në euro pranë BKT-së	1,542,310
C) PASURI NETO (A-B)	5,088,504
D) TË ARDHURA	5,626,869
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, SR, viti 2003	21,600
Të ardhura nga paga, SR	1,140,254
Të ardhura nga paga bashkëshorti 2003-2016	4,465,015
E) SHPENZIME	2,449,611
Shpenzime jetike vitet 2003-2016	564,096
Shpenzime për kreditë në euro pranë BKT-së	1,253,172
Shpenzime për kreditë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	386,976
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	245,368
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1,911,246

39.5. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për kryerjen e investimit dhe blerjen e truallit në vitin 2013 duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën - 1,911,246 lekë.

39.6. Mbi këtë balancë negative, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e mosmbulimit të investimeve lartcituara me burime të ligjshme, bazuar në pikën 5 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Subjekti në shpjegimet përfundimtare ka mbajtur të njëjtin qëndrim me atë të paraqitur në lidhje me blerjen e pasurisë “truall”, datë 2.9.2013, trajtuar më sipër, duke theksuar se për vitin 2013 nuk ka paguar vlerën prej 5,763,275 lekë, pasi kjo vlerë përfaqëson vetëm vlerën e rivlerësimit të pasurisë. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar që në këtë analizë, të përfshihen edhe të ardhurat e përfituara si eksperte gjatë vitit 2013 në vlerën prej 220,212 lekë, duke cituar të njëjtat prova sikurse të trajtuara më sipër në analizën për kontratën së shitblerjes së truallit datë 2.9.2013.

Analiza e fakteve dhe ligji i zbatueshëm

41. Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e pamjaftueshmërisë financiare për të përballuar investimet përgjatë vitit 2013. Pretendimet e subjektit mbeten të pabazuara, për sa subjekti nuk arriti të provojë moskryerjen e investimit për pagesën e çmimit të truallit, sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., dhe *** kol., datë 2.9.2013, arsyetuar më gjërë në seksionin e trajtimit të kontratës së shitblerjes së truallit datë 2.9.2013.

41.1. Gjithashtu, në lidhje me të ardhurat e pretenduara për vitin 2013 nga shërbimi, në total në vlerën prej 220,212 lekë, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen në analizën financiare, për sa subjekti nuk arriti t’i provojë me dokumentacion ligjor në formën

e kërkuar sipas ligjit. Gjithsesi, këto të ardhura nuk zënë një vend të konsiderueshëm në analizë në raport me rezultatin përfundimtar për vitin 2013.

41.2. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimet e kryera për vitin 2013, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën - 1,911,246 lekë. Për rrjedhojë, subjekti është në kushtet e aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika “b” të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me ndërtimin pa leje të shtëpisë së banimit

42. Nga hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri, rezultoi se shtëpia e banimit ka filluar të legalizohet në vitin 2006, kur subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë filluar procedurat e legalizimit në datën 8.11.2006.

42.1 Komisioni ka vlerësuar se subjekti është angazhuar aktivisht sipas ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” për të formalizuar ndërtimin e kryer pa leje. Në këtë pikë, ngritja e një ndërtimi pa leje, në kushtet kur në fuqi ka qenë të ligji nr. 8405/1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, vlerësohen si veprime, të cilat nuk përputhen me sjelljen etike të një magjistrati si gjatë ushtrimit të detyrës së tij, ashtu edhe jashtë veprimtarisë hetimore. Subjektit iu kërkuar shpjegime në lidhje me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

42.2 Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se ka qenë vendim i bashkëshortit të saj për të filluar investimin bashkë më vëllain e tij në vitin 2003, ndërsa në vijim është angazhuar aktivisht për ta legalizuar ndërtesën si një pasuri të krijuar gjatë martesës.

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

43. Trupi gjykues, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit vëren se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar shtëpinë e banimit në proces legalizimi duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin mbështetës⁵⁵. Nga analizimi i dokumentacionit, konstatohet se referuar aktit “vetëdeklarim për legalizimin e objektit” datë 8.11.2006⁵⁶, në të cilin është shënuar se shtëpia ka filluar të ndërtohet në datën 1.6.2003, ka *indicie* që tregojnë se ndërtimi i shtëpisë ka nisur përpara ushtrimit të detyrës si magjistrate⁵⁷. Më tej, vihet re se subjekti ka deklaruar për herë të parë ndërtimin e kësaj shtepie në DPV/2004 si “*Karabina shtëpie me vit krijimi pasurie vitin 2003*” si dhe ndër vite ka deklaruar fazat e ndërtimit. Nën dritën e këtyre fakteve, trupi gjykues vlerëson se posedimi i një ndërtimi të paligjshëm nga subjekti i rivlerësimit ndër vite përbën një sjellje që nuk përputhet me etikën profesionale të një magjistrati, i cili duhet të kujdeset për t’i garantuar publikut besimin tek dinjiteti dhe integriteti i organeve të drejtësisë. Por, nga ana tjetër, duke konsideruar faktin se shtëpia e banimit ka filluar të ndërtohet para fillimit të detyrës si magjistrate si dhe faktin se subjekti nuk e ka fshehur deklarin e kësaj ndërtese, të drejtat reale mbi të, ndër vite, duke e deklaruar gjëndjen e ndërtimit në deklaratat periodike si dhe në deklaratën “Vetting” procesin e legalizimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti është përpjekur me veprime aktive të ligjërojnë ndërtimin pa leje duke shfrytëzuar nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

43.1 Për rrjedhojë, në analizë të këtyre fakteve dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, trupi gjykues konkludon se veprimet e subjektit nuk duken të jenë në atë nivel sa të përbëjnë veçmas shkak për aplikimin e masës penalizuese në kuptim të nenit 61/5 të ligjit 84/2016.

⁵⁵ Aplikim vetdeklarimi për legalizim datë 08.11.2006, mandat arkëtim datë 21.12.2008, preventiv për vlerën e punimeve datë 01.03.2009, preventiv për rregullimim e ambienteve të papafingos 18.12.2012

⁵⁶ Pjesë e praktikës së ardhur me shpresën kthim përgjigjeje nga ASHK-ja nr. *** prot, datë 16. 6.2020.

⁵⁷ Sipas vërtetimit me nr. *** prot., datë 14.10.2016 subjekti ka filluar detyrën si prokurore në Rrethin Gjyqësor Kavajë më 1.10.2003.

44. Pasuria e llojit automjet, e markës “Opel Corsa” vit prodhimi 2003, datë blerje 21.09.2011, me targa AA***CG, në vlerën prej 450,000 lekë.

44.1. Burimi i krijimit: subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat personale të dy bashkëshortëve.

44.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në DPV/2011, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me përshkrimin “...Blerë makinë e tipit Opel Corsa të vitit 2003 në emër të Daniela Sulaj dhe P.S, në shumën 450,000 lekë...”, por nuk rezulton të ketë deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

45. Nga hetimi i kryer në lidhje me këtë pasuri⁵⁸, DPSHTRR-ja ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, i cili rezulton se është blerë⁵⁹ nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në datën 21.9.2011, kundrejt vlerës prej 450,000 lekësh, e paguar plotësisht sipas kontratës së shitblerjes.

Analiza financiare per blerjen e kësaj pasurie

45.1. Bazuar në deklarin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të kryer investimin në blerjen e kësaj pasurie në datë 21.9.2011, pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 9.

	21.09.2011
	1
A) PASURI	817,288
Investimi në shtëpinë private në rrugën “****” nr. *** Tiranë (sipas fazave të punimeve)	450,000
Automjet “Opel Corsa” vit prodhimi 2003, me targa DR***F (AA***CG) blerë më 21.9.2011	450,000
Ndryshim likuiditeti	-82,712
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	817,288
D) TË ARDHURA	3,494,138
Të ardhura nga paga, SR	1,121,490
Të ardhura nga paga bashkëshorti	2,372,648
E) SHPENZIME	1,957,692
Shpenzime jetike	409,860
Shpenzime për kredinë në euro pranë BKT-së	823,577
Shpenzime për kredinë pranë “Tirana Bank”	43,500
Shpenzime overdraft pranë bankës “Credins”	3,553
Shpenzime për kredinë pranë (PSHM; OPPORTUNITY; NOA)	591,456
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	85,746
Balanca e Fondeve (D-C-E)	719,159

⁵⁸ Kthim përgjigjeje nga DPSHTRR-ja, nr. ***, datë 7.5.2020.

⁵⁹ Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., 21.09.2011.

45.2. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të investuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit “Opel Corsa” në datën e blerjes dhe se mosdeklarimi i burimit të krijimit në deklaratën vjetore nuk e penalizon subjektin, për sa subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për të përballuar blerjen e kësaj pasurie.

46. Pasuria e llojit automjet, “Wolkswagen Turan”, vit prodhimi 2008, me targa AA *HA, blerë më 28.8.2015, në vlerën prej 1,120,000 lekë.**

46.1 Burimi i krijimit: subjekti ka deklaruar si burim krijimi kredi personale nga “Societe Generale Bank” në vlerën 1,000,000 lekë dhe të ardhurat e dy bashkëshortëve.

46.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në DPV/2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të e kanë deklaruar këtë pasuri me përshkrimin “...Blerje e makinës lloji autoveturë, marka Wolkswagen, TIP TURAN, në shumën 1,120,000 lekë (të ardhura nga pagat dhe nga kredia e marrë nga Banka Societe Generale Albania)...”

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

47. Nga hetimi i kryer në lidhje me këtë pasuri, DPSHTRR-ja⁶⁰ ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, i cili rezultoi se, është blerë⁶¹ nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në datën 28.8.2015, kundrejt vlerës prej 8,000 euro, e paguar plotësisht sipas kontratës së shitblerjes.

47.1. OTP Bank⁶² (ish-Societe Generale) ka konfirmuar se në datën 19.8.2015 subjekti dhe personi i lidhur kanë nënshkruar një kontratë kredie⁶³ për kreditimin e shumës prej 1,000,000 lekësh, me objekt “plotësim nevoja konsumatore”.

47.2. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë pranë kësaj banke në emër të personit të lidhur konstatohet se në datën 20.8.2015 është disbursuar kredia në vlerën prej 1,000,000 lekësh⁶⁴, ku në vijim në datën 25.08.2015 nga llogaria e personit të lidhur pranë “Societe Generale” transferohet⁶⁵ shuma prej 974,500 lekë në llogarinë e tij personale pranë BKT-së. Në datën 27.8.2015 nga llogaria personale e personit të lidhur pranë BKT-së shuma prej 1,120,000 lekë (ekuivalenti i shumës 8,000 euro) e përbërë nga shuma prej 974,500 lekë e transferuar më parë nga llogaria e tij në “Societe Generale” dhe pjesa tjetër në shumën 145,500 lekë, gjendje në llogarinë e personit të lidhur, transferohet⁶⁶ në llogarinë e palës shitëse⁶⁷.

47.3. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të kryer investimin në blerjen e kësaj pasurie në datë 28.08.2015, pasqyruar në tabelën si më poshtë.

Tabela nr. 10.

	28.08.2015
A) PASURI	1,624,037
Shtëpi private në rrugën “****” nr ***, Tiranë (sipas fazave të punimeve)	300,000

⁶⁰ Shkresa kthim përgjigje nga DPSHTRR-ja, nr ***, datë 7.5.2020.

⁶¹ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., 28.8.2015 e lidhur me shoqërinë “XH” sh.p.k.

⁶² Shkresa kthim përgjigjeje nr. ***, datë 8.5.2020 nga “OTP BANK”.

⁶³ Shkresa kthim përgjigjeje nr. ***, datë 8.5.2020 nga “OTP BANK”, faqe ***.

⁶⁴ Shkresa kthim përgjigjeje nr. ***, datë 8.5.2020 nga “OTP BANK”, faqe ***.

⁶⁵ Shkresa kthim përgjigjeje nr. ***, datë 8.5.2020 nga “OTP BANK”, faqe ***.

⁶⁶ Referohu shkresës kthim përgjigjeje nr. ***, datë 26.5.2020 nga “BKT Bank” pjesa ***, faqe ***.

⁶⁷ Shoqëria “XH” sh.p.k.

Automjet Wolkswagen Turan, me targa AA***HA, blerë më 28.8.2015	1,120,000
Ndryshim likuiditeti	204,037
TOTAL LIKUIDITETE	437,116
B) DETYRIME	1,000,000
Kredia pranë Bankës “Societe Generale”	1,000,000
C) PASURI NETO (A-B)	624,037
D) TË ARDHURA	3,876,040
Të ardhura nga shkolla e magjistraturës, SR	41,432
Të ardhura nga paga, SR	256,466
Të ardhura nga paga, bashkëshorti	3,149,104
Të ardhura nga ISSH (leje lindje)	259,038
Të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit 71.5 m ² , në rrugën “***”.	170,000
E) SHPENZIME	1,830,454
Shpenzime jetike	747,587
Shpenzime për kredinë në euro pranë BKT-së	738,905
Shpenzime për kredinë pranë “Societe Generale Albania”	178,782
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	165,180
Balanca e Fondeve (D-C-E)	1,421,549

47.4. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të investuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie.

48. Pasuria e llojit Cash në bankë dhe jashtë banke në vlerën 350,000 lekë

48.1. Subjekti dhe personi i lidhur me të, nuk kanë deklaruar në deklaratën “Vetting” burimin e krijimit të kësaj pasurie.

48.2. Deklarimi i kësaj pasuri në vite: subjekti ka deklaruar në disa deklarata periodike gjëndje të llogarisë: Në DPV/2007- “...Gjendje para-në dorë dhe në bankë Daniela Sulaj 55,000 lekë dhe P.S 150,000 lekë...”.

Në DPV/2012- “...Pakësim të gjendjes cash në llogari korrente në bankë të P.S dhe Daniela Sulaj të marra sëbashku në shumën 71,453 lekë...”.

Në DPV/2013- “...Shtim të gjendjes cash në llogari korente në bankë P.S dhe Daniela Sulaj të marra sëbashku, në shumën 311,530 lekë...”.

Në DPV/2014- “...Shtim i gjendjes cash në llogari korente në bankë të Daniela Sulaj në shumën 6,534 lekë. Pakësim i gjendjes cash në llogari korente në bankë P.S në shumën 236,427 lekë...”.

Në DPV/2015- “...Shtim i gjendjes cash në llogari korente në bankë Daniela Sulaj në shumën 5,517 lekë...” “... Shtim i gjendjes cash në llogari korente në bankë të P.S, (të ardhura nga pagat), shuma 43,084 lekë...”.

Në DPV/*2016- “...Pakësim të gjendjes cash në llogari korente në bankë të Daniela Sulaj, në shumën 32,982 lekë...” “...Pakësim të gjendjes cash në llogari korente në bankë të P.S, në shumën 69,705 lekë...”.

48.3. Referuar deklarimeve të subjektit, nga viti 2003-2016 dhe dokumentacionit financiar të administruar, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar vetëm shtesa /pakësime të likuiditeteve në llogari bankare dhe jo gjendje cash në banesë, për rrjedhojë rezulton se gjendja e likuiditeteve cash e deklaruar deri në datën 31.12.2016 ka qenë 0 (zero).

48.4. Nga hetimi i kryer⁶⁸ rezulton se në datën e dorëzimit të deklaratës “Vetting” 24.1.2017 subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur gjendje në bankë në total në shumën 29,215 lekë, përkatësisht shumat 7,477 lekë në BKT dhe 21,738 lekë në “Credins Bank”.

48.5. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit bankar deri në datën 24.1.2017, konstatohet se subjekti dhe personi i lidhur më të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjëndjes *cash* në shumën 320,785 lekë.

48.6. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me: i) pamjaftueshmërinë financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme krijimin e gjëndjes *cash* në shumën 320,785 lekë; ii) mosdeklarimin e burimit të krijimit në deklaratën “Vetting”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

49. Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se në fund të vitit 2016 ka pasur në banesë gjendje *cash* shumën prej 2,400 eurosh, e cila ishte tërhequr më parë në datën 1.8.2016 nga personi i lidhur me të, e cila është harruar të deklarohet në DPV/2016. Për të provuar këtë deklaram, subjekti paraqiti si provë dy fletë të printuara të një ekstrakti bankar datë 22.2.2018, pa ekstremitetet e duhura të një dokumenti bankar, për të provuar se në datën 1 gusht 2016 bashkëshorti i saj ka tërhequr shumën prej 5100 euro, një pjesë nga e cila subjekti ka sqaruar se është shpenzuar ndërsa pjesa tjetër ka qenë gjendje *cash* në banesë në fund të vitit 2016.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

50. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se ka pasur gjendje *cash* të ruajtur në banesë, të mjaftueshme për të justifikuar gjendjen e deklaruar në “Vetting”, nuk është i bazuar në ligj, pasi bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti ka patur detyrimin për të deklaruar brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë dhe se deklarimi në “Vetting” nuk justifikon mosdeklarimin vjetor të vitit 2016.

50.1. Dokumenti bankar i datës 22.2.2018 i paraqitur nga subjekti nuk përmban ekstremitetet e duhura të një dokumenti zyrtar bankar, për këtë arsye ky dokument nuk merr vlerën e provës. Pavarësisht kësaj, Komisioni kryesisht identifikoi nga hetimi bankar, një transaksion tërheqje datë 1 gusht 2016 në BKT⁶⁹, ku bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën prej 5100 euro, por ky transaksion nuk mund të konsiderohet si burim krijimi për gjendjen *cash* të cilën subjekti e ka pretenduar si gjendje në banesë në fund të vitit, për sa nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016.

50.2. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën mbi pamjaftueshmërinë financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme krijimin e gjëndjes *cash* në shumën 320,785 lekë, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Pasuri të tjera të deklaruara në deklaratat periodike vjetore

51. Trupi gjykues, në lidhje me automjetet “Mercedes- Benz” me targa TR *** I, vit prodhimi 1987, blerë në janar 2004, në vlerën prej 430,000 lekë dhe automjetin “Mercedes- Benz” me targa TR***H vit prodhimi 1987, i deklaruar nga subjekti në DPV/2004, pas hetimit dhe administrimit të shpjegimeve përfundimtare të subjektit, arrin në përfundimin se ato janë bindëse dhe nuk konstatohen problematika.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020 BKT-ja; shkresë nr. *** prot., 17.8.2020 “Credins”.

⁶⁹ Shkresë me nr. *** prot., datë 22.5.2020

ÇËSHTJE TË TJERA

52. Nga hetimi ka rezultuar lidhja e një kontrate dhurimi nr. *** rep., dhe *** kol., datë 10.11.2013, sipas të cilës subjekti i rivlerësimit i ka dhuruar nënës së saj S.K pjesën takuese prej 3/10 të një pasurie, apartament me sip. 88,7 m², të ndodhur në G, të cilën nuk e ka deklaruar. Pas shpjegimeve të administruara dhe analizës së fakteve, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk ka patur detyrimin ta deklarojë këtë pasuri, pasi në kohën e përfitimit me ligjin e privatizimit subjekti nuk ka qenë madhore dhe në vijim në vitin 2013 është çelur dëshmia e trashëgimisë për të ndjerin babain e saj ku subjekti i ka dhuruar të ëmës pjesën e saj takuese si trashëgimtare ligjore.

ANALIZA FINANCIARE PËR VITET 2003 – 2016

53. Në lidhje me analizën financiare, subjekti nuk paraqiti pretendime, përveçse rezultatit financiar të vitit 2013 dhe për blerjen e pasurisë truell në datën 2.9.2013, për të cilat trupi gjykues është shprehur në këtë vendim në seksionet përkatëse.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kriterit të pasurisë

54. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë truell në datën 02.09.2013 dhe investimin e kryer për shtëpinë e banimit në vitin 2013, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 germa “b” e nenit 33 të ligjit 84/2016, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën prej - 3,408,493 lekë në datën e blerjes dhe për vitin 2013 në shumën - 1,911,246 lekë.

54.1. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart dhe në konsideratë të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, subjekti i rivlerësimit znj. Daniela Sulaj nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

55. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ai ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

55.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës⁷⁰ për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

55.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Znj. Daniela Sulaj.

55.3. Nga hetimi i pavarur i Komisionit, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

⁷⁰ Raport me nr. *** prot., datë 30.10.2017 deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** datë 20.1.2021, të KDZH-së.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

55.4. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti profesional i përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë⁷¹

55. Raporti profesional është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

55.1. Ky raport është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: i) formularit të vetëdeklarimit; ii) 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; iii) 5 (pesë) dosje penale , të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; iv) Të dhënat nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme. v) Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

55.2. Sipas raportit janë analizuar të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, në përfundim të të cilit, kanë rezultuar këto gjetje:

a) në lidhje me aftësitë profesionale: subjekti i rivlerësimit identifikon saktë, normën ligjore të zbatueshme, shfaq aftësi në arsyetim ligjor, duke përpiluar akte me një gjuhë të kuptueshme dhe në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike.

b) në lidhje me aftësitë organizative: subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi për të përballuar ngarkesën në punë me efektivitet, si dhe ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore.

c) në lidhje me etikën dhe vlerat profesionale: subjekti i rivlerësimit shfaq etikë dhe gjuhë e përdorur në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

ç) në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimi profesional vihet re se komunikimi i subjektit të rivlerësimit është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Ajo ka aftësi për të bashkëpunuar dhe ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale.

Të dhënat arkivore lidhur me masat disiplinore, ankesat dhe vlerësime

56. Referuar burimeve arkivore, subjekti i rivlerësimit znj. Daniela Sulaj nuk ka pasur masa disiplinore dhe nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

Mbi ankesat e regjistruara për subjektin e rivlerësimit

57. Referuar informacionit të marrë nga prokuroritë e rretheve dhe nga regjistri i ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit rezultojnë:

⁷¹ Raport profesional me nr. *** prot., datë 17.11.2020.

i) 2 (dy) procedime penale të regjistruara ndaj saj si prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës Shkallës së Parë Durrës, përkatësisht: a) procedim penal nr.*** i vitit 2016 mbi bazën e kallëzimit kryer nga shtetasi B.N në cilësinë e administratorit të shoqërisë përmbarimore “A”sh.p.k., për moskryerje veprimesh hetimore në lidhje me një kallëzim të kryer ndaj këtij shtetasi, i përfunduar me pushim procedimi, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe b) procedim nr. *** i vitit 2020 mbi bazën e kallëzimit të kryer nga shtetasja E.F për mosveprim të subjektit për të njoftuar këtë shtetase në cilësinë e kallëzueses për mënyrën e përfundimit të procedimit penal, i përfunduar me pushim procedimi, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale për sa është provuar kryerja e njoftimit të kësaj shtetase nëpërmjet shërbimit postar; ii) 5 (pesë) ankesa për periudhën viti 2006 – 2020, për të cilat, Komisioni duke vlerësuar rrethanat, i kërkoi subjektit shpjegime, të cilat i paraqiti me shpjegimet përfundimtare bashkë me dokumentacionin mbështetës.

57.1. Ankesë e shtetases E.R⁷² ndaj subjektit të rivlerësimit për njëanshmëri në hetimet e kryera në lidhje me një kallëzim të paraqitur nga ajo ndaj një shtetasi për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe shpërdorimit të kompetencave. Sipas ankueses, ka kërkuar ka kërkuar që të bëhet zëvendësimi i prokurores me një prokuror tjetër.

Në lidhje me këtë ankesë subjekti ka dhënë sqarime të detajuara duke shpjeguar se ankuesja ka bërë kallëzim penal në Prokurori për veprën penale falsifikim të dokumenteve dhe shpërdorim detyre. Në datën 24.1.2018, subjekti ka vendosur të regjistrojë procedimin penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Në datën 25.1.2018 ka vendosur bashkimin e dy procedimeve penale⁷³në një procedim të vetëm pasi rrethanat e njërit procedim ndikonin në tjetrin, për hetimin e të cilit është ngarkuar një prokuror tjetër.

57.2. Ankesë e shtetases B.K⁷⁴ ndaj subjektit të rivlerësimit për paragjykim të çështjes, sipas të cilës kjo shtetase është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në vitin 2015 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

Në lidhje me këtë ankesë subjekti ka sqaruar se ka kryer të gjitha veprimet hetimore, në përfundim të të cilave ka disponuar me vendimin për dërgimin në gjyq të kësaj shtetase për veprën penale “shpërdorim detyre”, vendim i cili është miratuar nga gjykata, duke e deklaruar fajtoreshë të pandehurën për këtë vepër penale.

57.3. Ankesë e shtetasit R.M⁷⁵ ndaj subjektit të rivlerësimit për zvarritje hetimi në lidhje me një kallëzim penal të paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, në vitin 2017 me objekt të përgjithshëm falsifikim i dokumenteve me qëllim përfitimin e një pasurie të paluajshme.

Në lidhje me këtë ankesë, subjekti ka sqaruar se ka kryer hetimet e plota për këtë kallëzim dhe në përfundim i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë me kërkesën për pushimin e procedimit penal, e cila ka vendosur pushimin e procedimit, duke paraqitur dhe një kopje të vendimit të gjykatës.

57.4. Ankesë e shtetases R.M⁷⁶ ndaj subjektit të rivlerësimit për moskryerje hetimi të plotë dhe njëanshmëri e subjektit në lidhje me një kallëzim penal me objekt “falsifikimi i dokumenteve”, të paraqitur nga kjo shtetase në vitin 2017, për të cilin është regjistruar procedimi penal nr.*** dhe pas kryerjes së disa hetimeve subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendim pushimi.

⁷² Praktika nr.***, datë 17.1.2018.

⁷³ Procedim nr. *** me procedim nr. ***.

⁷⁴ Praktika nr. ***, datë 6.4.2018.

⁷⁵ Praktika nr. ***, datë 21.1.2019.

⁷⁶ Praktika nr.***, datë 12.9.2019.

Subjekti ka sqaruar se vendimmarrja ka qenë e mbështetur në provat e administruara në fashikullin e procedimit dhe në ligjin material dhe procedural. Pas kryerjes së hetimit të plotë, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesën për pushim, e cila ka vendosur pushimin e procedimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, duke paraqitur dhe kopje të akteve mbështetëse në lidhje me këtë çështje.

57.5. Ankesë e shtetasit A.Sh⁷⁷ ndaj subjektit të rivlerësimit për njëanshmëri në hetimin e çështjes për të cilën ka bërë kallzim penal në vitin 2010 me objekt veprën penale “falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 Kodit Penal, duke pretenduar në këtë ankesë se subjekti ka favorizuar të kallëzuarit prej tij.

Subjekti ka sqaruar se në lidhje me këtë çështje ka kryer të gjitha veprimet hetimore dhe në përfundim ka disponuar me vendim pushimi. Subjekti ka sqaruar Komisionin se pas njoftimit të vendimit të pushimit ankuesit, ai ka paraqitur në gjykatë ankim ndaj vendimit si dhe tek Drejtuesi i Prokurorisë kërkesë për zëvendësimin e saj, kërkesa të cilat nuk janë pranuar. Vendimi i Gjykatës së Rrethit për mospranim ankimi është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit. Subjekti ka paraqitur kopje të akteve mbështetëse.

57.6. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre ankesave dhe pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues arrin në përfundimin se ato janë bindëse dhe nuk rezultojnë indicie të tjera për hetime të mëtejshme, në kuptim të vlerësimit të aftësive profesionale.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

58. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore, mbi të cilat është hartuar raporti, në përfundim të të cilit u evidentuan këto gjetje për 2 dosje nga aktet e shortuara:

58.2. Në lidhje me dosjen nr. 2: procedim penal nr.***, datë regjistrimi 11.09.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shortimi: vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 27.5.2014, në të cilin shkurtimisht referohen këto fakte dhe veprime hetimore të kryera nga subjekti.

58.2.1. Një shtetas anglez i quajtur M.D.E.W ka kallëzuar fakte ndaj shtetasit E.D në lidhje me disa veprime të paligjshme të kryera nga ai gjatë kohës së ekzistencës së sipërmarrjes tregtare midis tyre, ku ka referuar midis të tjerave edhe disa fakte mitmarrjeje ku përfshihen zyrtarë të lartë si z. E.H, në lidhje me favorizimin për marrjen e licencës për krijimin e një resorti turistik në G të Kavajës.

58.2.2. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka marrë kallzimin, ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, ndër të cilat: i) kërkimin e informacionit në QKB në lidhje me regjistrimin e shoqërisë dhe gjëndjen aktuale; ii) kërkimin e informacionit nga banka për tërheqjen e shumës së parave nga shtetasi M.D.E.W, iii) kërkimin e informacionit Ministrisë së Transporteve për pamjet filmike, ku zyrtari i lartë në kohën e referuar ka patur detyrën e zëvendëministrit të kësaj ministrie; iv) këqyrjen e librit të hyrje daljeve të personave në Ministrinë e Jashtme për periudhën e referuar nga kallëzuesi, ku zyrtari i lartë ka pasur detyrën e Ministrit të kësaj ministrie; v) marrjen në pyetje të shtetasve E.D dhe E.H. Në përfundim të veprimeve subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes për veprën penale të mashtrimit ndaj shtetasit E.D me arsyetimin se nuk provohet ana objektive e veprës penale të mashtrimit.

⁷⁷ Praktika nr.***, datë 29.3.2019.

58.3. Nga analizimi i kësaj dosje, u vërejtën disa gjetje, të cilat përqendroheshin kryesisht në evidentimin e qëndrimit pasiv të subjektit në drejtim të kryerjes së veprimeve të plota hetimore për zbardhjen e fakteve të tjera penale të referuara në kallëzim ndaj subjekteve të posaçëm, funksionarë të lartë të shtetit, fakte të cilat për nga rëndësia përfshihen në kategorinë e krimeve kundër autoritetit të shtetit parashikuar në nenet 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë”; neni 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, neni 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë” të Kodit Penal.

58.3.1. Nisur nga rëndësia e këtyre veprave penale, trupi gjykues i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me: **a)** arsyet e mbylljes së hetimit vetëm në lidhje me veprën penale të mashtrimit për E.D, pa u shprehur kryesisht për veprimet e tjera penale, në të cilat referohen persona të tjerë, funksionarë të lartë të shtetit **b)** nëse gjatë kryerjes së hetimeve, e kishte kontaktuar shtetasin anglez, si kallzues në cilësinë e prokurores së çështjes me qëllim për të marrë më shumë informacion nga ai në lidhje me faktet e referuara në kallëzim apo nëse kishte administruar mesazhet/ komunikimet telefonike që mund të ketë patur ai me shtetasin E. D në lidhje me këto fakte; **c)** nëse subjekti kishte identifikuar natyrën e marrëdhënies midis shtetasve E.D dhe z. E.H nisur nga faktet e kallëzuara; **d)** se përse nuk e thirri si dëshmitar shtetasin e huaj të quajtur J.M, i cili referuar fakteve diktohet si personi që ka qenë prezent në një nga takimet e kryera me z. E.H; **e)** se përse nuk vlerësoi thirrjen e kallëzuesit dhe të kallëzuarve për ballafaqimin midis tyre në lidhje me rrethanat kontradiktore të konstatuara në hetim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

58.4. Në prapsimet e saj, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se pavarësisht regjistrimit të procedimit për veprën penale të mashtrimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, për të zbardhur faktet, dhe se pavarësisht se kanë ekzistuar *indicie*, dyshimi nuk ngrihej në nivelin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, duke përsëritur kështu të njëjtat veprime hetimore të evidentuara nga Komisioni gjatë administrimit të kësaj dosje. Në lidhje me këtë çështje, subjekti ka theksuar, ndër të tjera, se ka qenë prezent kur është pyetur shtetasi anglez, pavarësisht se procesverbali është mbajtur në emrin e oficerit të policisë gjyqësore, por është nënshkruar edhe nga vetë ajo. Më tej, subjekti ka shpjeguar se referuar deklarimeve të dhëna, shtetasit D dhe H kanë pranuar që të jenë takuar disa herë vetëm të tre bashkë me shtetasin anglez ose dhe me të tjerë në zyrën e ministrit, por se asnjëri prej tyre nuk ka pranuar faktet penale. Në përfundim, subjekti ka theksuar se janë kryer të gjitha veprimet hetimore pa u limituar në faktin penal të mashtrimit, por nga hetimi nuk ka rezultuar konsumimi i elementeve të ndonjë veprave penale.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

59. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit dhe pasi e dëgjoi atë në seancën dëgjimore, vlerëson se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me kryerjen e veprimeve të plota hetimore për zbardhjen e fakteve penale të referuara në kallëzim për kryerjen e veprimeve korruptive nga funksionarë të lartë shtetërorë. Subjekti nuk arriti t'i arsyetojë Komisionit se veprimet hetimore të ndërmarra ishin të mjaftueshme për të hetuar në lidhje me faktet penale korruptive, për sa nga analiza e dosjes penale rezultoi se faktet e referuara nga kallzuesi dhe të deklaruara nga shtetasit e marrë në pyetje nga subjekti konvergonin me njëra tjetrën në të njëjtën pikë, atë të takimit me funksionarët e lartë shtetërorë⁷⁸ për favorizimin e marrjes së një licence për ushtrimin e aktivitetit turistik në fshatin G të Kavajës, në kushtet kur, për marrjen e një licence të tillë, nuk është e nevojshme kryerja e takimeve në zyrë me funksionarët e lartë të shtetit, por zbatimi i kërkesave ligjore në kuptim të

⁷⁸ Në dosjen penale referohen përveçse emri i z. E.H si ish Ministër, edhe takime të tjera të kryera si në zyrën e ish Kryeministrit, ish ministrit të turizmit apo të ish këshilltares të kryeministrit-shih procesverbalin kur është pyetur z. E.D

legjislacionit në fuqi që rregullon licencimin dhe ushtrimin e aktivitetit turistik nga subjektet tregtare. Ekzistenca e fakteve të tilla, për trupin gjykues janë të mjaftueshme për të kuptuar se subjekti i rivlerësimit i ka shmangur hetimet e nevojshme për të zbardhur faktet penale që i atribuoheshin funksionarëve të lartë të shtetit. Trupi gjykues vlerëson të pabazuar qëndrimin e subjektit se paraqitja me vonesë e kallzimit penal për faktet e ndodhura në vitin 2010 dhe 2011, e kanë penguar atë në kryerjen e veprimeve speciale të mëtejshme hetimore, pasi nga analiza e veprimeve hetimore nuk rezulton që subjekti të jetë angazhuar për ndërmarrjen e veprimeve hetimore proaktive me qëllim zbardhjen e fakteve të referuara si korruptive. Gjithashtu, të pabazuara vlerësohen edhe përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të lidhur përfundimin e procedimit penal me faktet e padisë civile të hapura nga të njëjtat palë në Gjykatën e Tiranës, pasi nga analiza e fakteve dhe shpjegimet e subjektit nuk rezultoi lidhja midis tyre.

59.1. Trupi gjykues bazuar në analizën e fakteve konkludon se subjekti me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka treguar kujdesin dhe vlerësimin e nevojshëm për ndjekjen e hetimeve të duhura në funksion të zbardhjes së ngjarjes dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve përkatës, por duke e vlerësuar në tërësi bazuar në kriteret e rivlerësimit profesional sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 e në bazë të parimit të proporcionalitetit, rrethanat e analizuara më sipër nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar ndaj subjektit të rivlerësimit masën disiplinore sipas nenit 61 pika 4, nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, nenit E pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

60. Në lidhje me dosjen nr. 3: procedim penal nr. ***, datë regjistrimi 14.12.2012, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shortimi: vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 9.10.2013, për procedimin penal nr. ***, regjistruar datë 14.12.2012, në të cilin shkurtimisht paraqiten këto fakte që lidhen me kallzimin e disa qytetarëve ndaj mjekut kardiolog z. E.P, me detyrën e Shefit të Shërbimit të Kardiologjisë të QSUT-së “Nënë Tereza”, ku kanë kallzuar se për kryerjen e operacioneve, ky shtetas iu kërkonte para. Në lidhje me këtë procedim, rezultoi se subjekti ka kryer disa veprime hetimore dhe në përfundim ka vendosur pushimin e procedimit.

60.1. Komisioni e analizoi këtë dosje nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime shteruese hetimore, për sa rezultonte se: **a)** referuar deklarimeve të shtetasve M.H dhe B.Sh, konstatohet se ka pasur mospërputhje për fakte e rrethana të caktuara me ato të dhëna prej shtetasit E.P. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 169 të Kodit Procedurës Penale, mund të kishte kryer ballafaqimin e shtetasve; **b)** nga faktet e administruara, referohet emri i kryeinfermieres F nga dy kallzuesit si person kontakti me mjekun z. E.P. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ndërmarrë ndonjë veprim procedural për identifikimin e gjeneraliteteve të kryeinfermieres që referohet në kallzimin dhe ta thërrasi këtë shtetase në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit; **c)** në lidhje me kohëzgjatjen e veprimeve hetimore, konstatohet se nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi ka kaluar një kohë e gjatë rreth 10 muaj; **ç)** nga analizimi i dosjes në lidhje me kohëzgjatjen e veprimeve hetimore është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit penal në ngarkim të shtetasit E.P në datën 14.12.2012, ka urdhëruar policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore, e cila për një periudhë 3-mujore ka realizuar një sërë veprimesh hetimore. Prej muajit prill vitit 2013 deri në datë 23.09.2013 kur është bërë relacioni me sugjerimin mbi përfundimin e hetimit nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga subjekti i rivlerësimit. Rezulton se subjekti ka vijuar të kryejë veprime hetimore jashtë afatit procedural, parashikuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve; **d)** në lidhje me njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka disponuar në vendim për detyrimin e njohjes të palëve të interesuara, por ky vendim nuk duket se i është njoftuar palëve

pasi në fashikullin e procedimit penal nr. *** të vitit 2012 nuk rezulton të ketë njoftim në formën e kërkuar nga ligji procedural penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

61. Subjekti në shpjegimet përfundimtare ka paraqitur një përmbajtje të veprimeve procedurale të kryera që nga regjistrimi i procedimit, e në vijim autorizimi i oficerëve të policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve vëzhguese ndaj mjekut, marrja në pyetje e personave të referuar në kallëzim e deri tek autorizimi për një periudhë të caktuar për kryerjen e përgjimeve ambientale. Subjekti pas relatimit të këtyre veprimeve, ka shpjeguar se nga analiza e veprimeve nuk u arrit të provohej që mjeku të ketë kryer veprime të natyrës korruptive.

61.1. Në lidhje me konstatimin mbi kalimin e afateve procedurale të hetimit, subjekti pretendoi se nuk ka patur tejkallim të afateve pasi vendimi është marrë pas administrimit të relacionit të policisë gjyqësore mbi mënyrën e përfundimit të çështjes penale. Ndërsa në lidhje me mosnjoftimin e vendimit ndaj palëve, subjekti ka shpjeguar se vendimi nuk është njoftuar palëve duke arsyetuar se ka patur parasysht faktin se procedimi penal është regjistruar mbi bazën e informacionit të referimit të paraqitur kryesisht nga Drejtoria e Policisë Tiranë dhe se hetimi dhe relacioni për pushimin e procedimit ishte bërë nga OPGJ-ja që kishte referuar materialin kallëzues.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

62. Trupi gjykues pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore shteruese në lidhje me zbardhjen e fakteve penale ndaj mjekut z. E.P. Nga analiza e fakteve në raport me veprimet hetimore të kryera nga subjekti, duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë pasiv për kryerjen e veprimeve të duhura hetimore.

62.1. Gjithashtu, subjekti nuk arriti t'i shpjegojë Komisionit mbi arsyet e zgjatjes së afatit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal si dhe mbi mosmarrjen e vendimit për zgjatje afati, sikurse kërkohet nga legjislacioni procedural penal.

62.2. Përsa i takon mos kryerjes së njoftimit ndaj palëve në lidhje me vendimin e mosfillimit, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar arsyetimin e subjektit dhe përpjekjen e saj për ta lidhur me detyrat e oficerit të policisë gjyqësore, për arsye se prokurori ka kompetencë funksionale regjistrimin, disponimin me vendim në lidhje me hetimet e çështjes si dhe ka detyrimin për njoftimin e palëve në lidhje me vendimin përfundimtar të marrë, ndërsa oficeri i policisë gjyqësore kryen veprimet hetimore në zbatim të urdhërit të prokurorit të çështjes.

62.3. Nga analiza e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se gjetjet e konstatuara në lidhje me këtë çështje, nuk janë në atë masë sa të cenojnë nivelin profesional të subjektit, në kuptim të ligjit 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, parë kjo nën dritën e tërësisë së burimeve të rivlerësimit.

DENONCIMET

63. Në rivlerësimin e kryer ndaj subjektit të rivlerësimit, u administruan edhe 13⁷⁹ denoncime nga publiku, për të cilat pas vlerësimit me objektivitet nga Komisioni, nuk u gjetën *indicie* në

⁷⁹ 2 denoncime të përsëritura të shtetasës V.T; denoncim i regjistruar me nr. *** prot., datë 5.1.2021 pranë Komisionit si dhe denoncim përcjellë nga Institucioni i Komisionerit Publik me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2021 me objekt “moskryerje të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit”; 4 denoncime të përsëritura të shtetasit B.B, regjistruar përkatësisht me nr. *** prot., datë 16.1.2018; me nr. *** prot., datë 23.1.2018; me nr. *** datë 23.01.2018; me nr. ***, datë 15.11.2018 me objekt “ankesë ndaj vendimit të pushimit të procedimit dhe zvarritje të hetimeve”; 2 denoncime të përsëritura të shtetasit V.Ç me nr. *** prot., datë 14.06.2019, si dhe nr. *** prot., datë 10.7.2019, përcjellë nga Institucioni i Komisionerit Publik me objekt “ankim vendimi”; 2 denoncime të përsëritura të shtetasit A.Z, nr. *** prot., datë 7.6.2018, si dhe nr. *** prot., datë 19.7.2018 me objekt “ankim

lidhje me kriterin profesional ndaj subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me një denoncim të paraqitur nga publiku⁸⁰, Komisioni, duke vlerësuar rrethanat e denoncimit dhe kohën që kishte kaluar nga depozitimi i tij, kërkoi nga subjekti shpjegime, në përgjigje të të cilave, pas paraqitjes së detajuar, përfshirë dhe ecurinë e procedimit të çështjes si dhe dokumentacionin mbështetës, u vlerësua se nuk u gjetën indicie në kuptim të kritereve të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për kriterin profesional

64. Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të burimeve që kanë shërbyer për rivlerësimin profesional të subjektit, trupi gjykues vëren se sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i rivlerësimit të aftësive profesionale është të identifikojë magjistratët që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Trupi gjykues, bazuar në sa më lart dhe në mbështetje të jurisprudencës së Kolegjit⁸¹, vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit e parashikuar në ligjin nr. 96/2016.

64.1. Si konkluzion, për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, duke vlerësuar në tërësi burimet që kanë shërbyer për vlerësimin profesional të subjektit dhe bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me dosjet numër 2 dhe numër 3, nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

65. Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej -3,408,493 lekë për të përballuar blerjen e pasurisë “truall” në datën 2.9.2013 dhe në shumën - 1,911,246 lekë për të përballuar investimin e kryer për shtëpinë e banimit në vitin 2013, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, germa “b” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenin 58, germa “c”, si dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit”; denoncim i paraqitur nga shtetasi I.C, me nr. *** prot., datë 27.5.2019 me objekt “zvarritje hetimesh”;

- Denoncim i paraqitur nga shtetasi M.Zh.L, regjistruar me nr. *** prot datë 22.10.2018, i paqartë, i palexueshëm.

⁸⁰ Denoncim i paraqitur nga familjarët T, me nr. *** prot. datë 1.06.2018

⁸¹ Vendimi nr. 21, datë 13.9.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj, me funksion prokurore, aktualisht magjistrate e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose nga Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 27.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland Ilia
Kryesues

Etleda Çiftja
Anëtare

Pamela Qirko
Relatore

Ertugena Sokoli/Amela Idrizi
Sekretare gjyqësore

Analiza financiare

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	3 449 336	5 855 369	-510 078	777 866	-2 008	6 972 783	936 992	648 409	962 191	449 917	6 630 814	-337 290	1 469 540	197 957
Apartament banimi me sip 71.5 m2, në Rr "****" pranë "Z.C".		2 914 483												
Trrall me sipërfaqe 226m2 në rrugën "****"	1 950 000										5 763 275			
Shtëpi private në rrugën "****" Tiranë (sipas fazave të punimeve)	1 200 000	1 800 000		750 000		5 500 000	2 500 000	700 000	450 000	450 000	450 000		300 000	300 000
Automjet "****" me targë ***	293 463													
Automjet *** me targë ***		430 000												
Automjet *** me targa ***									450 000					
Automjet *** me targa ***													1 120 000	
Ndryshim likuiditeti	5 873	710 886	-510 078	27 866	-2 008	1 472 783	-1 563 008	-51 591	62 191	-83	417 539	-337 290	49 540	-102 043
B) DETYRIME	293 463	5 408 904	1 000 000	859 000	500 000	6 811 388	2 861 662	11 112 157	0	0	1 542 310	0	1 000 000	0
Kredi pranë Institucionit financiar jo -Bankë (**, ***, ****)	293 463	390 000	1 000 000	859 000		2 500 000	881 662							
Kredi pranë Bankës BKT (euro)		5 018 904				4 311 388		11 112 157			1 542 310			
Kredi pranë Bankës BKT(lekë)							1 980 000							
Kredia pranë Bankës Tirana					500 000									
Kredia pranë Bankës Societe Generale													1 000 000	
C) PASURI NETO (A - B)	3 155 873	446 465	-1 510 078	-81 134	-502 008	161 396	-1 924 670	-10 463 748	962 191	449 917	5 088 504	-337 290	469 540	197 957
D) TË ARDHURA	6 701 408	2 775 058	3 533 515	3 131 450	3 853 232	4 323 423	4 640 694	4 592 372	5 577 254	4 716 748	5 626 869	6 004 589	5 810 102	6 661 262
Të ardhura nga shkolla e magjistraturës SR 2003	239 420										21 600	43 200	41 432	
Të ardhura nga shkolla e magjistraturës SR 2001-2002	351 240													
Të ardhura nga paga SR	61 600	774 000	862 298	169 339	706 072	803 601	778 974	1 032 128	1 397 184	1 165 156	1 140 254	751 084	675 708	1 355 210
Të ardhura nga paga e SR nga Fondacioni ****													64 005	70 346
Të ardhura nga vendimi i gjykatës Durrës SR									623 522					
Të ardhura nga paga bashkëshorti 2003- vijim	1 832 455	1 994 329	2 669 646	2 636 414	3 056 849	3 219 822	3 856 364	3 560 244	3 556 548	3 551 592	4 465 015	4 660 928	4 514 919	4 967 956
Të ardhura nga paga bashkëshorti 1999-2002	4 216 693													
Të ardhura nga ISSH (leje lëndje) SR				325 697	90 311							391 877	259 038	
Të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit 71.5 m2, në Rr "****"												157 500	255 000	267 750
Të ardhura nga shitja e automjetit *** me targë ***						300 000								
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat		6 729	1 571				5 356							
E) SHPENZIME	2 232 455	800 362	1 743 055	1 875 663	2 171 606	2 234 381	4 497 335	13 326 329	2 552 439	2 531 955	2 449 611	3 017 901	2 573 425	3 162 712
Shpenzime jetike 2003-2016	281 592	281 592	328 671	410 839	546 480	546 480	546 480	546 480	546 480	564 096	564 096	989 991	1 121 380	1 175 460
Shpenzime jetike 1999-2002	854 501													
Shpenzime për qiranë/këstet për apartamentin 71.5 m2 në Rr. **** 2003-vijim ***	292 159	190 673												
Shpenzime për qiranë/këstet për apartamentin 71,5 m2 në Rr. ****2001-2002 ***	493 140													
Shpenzime mobilimi shtëpia private Rr "****" nr ****							1 690 000					540 000		
Shpenzime mobilimi / mirëmbajtje apartamenti Rr ***				70 000	60 455					90 818		150 000		
Shpenzime për kredinë pranë BKT EURO		88 211	515 403	477 617	551 591	795 020	966 225	9 402 157	1 099 208	1 103 089	1 253 172	1 148 762	1 108 083	1 091 358
Shpenzime për kredinë pranë BKT LEKë							206 519	2 175 108						
Shpenzime për kredinë pranë Tirana Bank					128 900	171 700	174 450	174 300	43 500					
Shpenzime për kredinë pranë Societe Generale Albania													178 782	537 428
Shpenzime over draft pranë Bankës Credins								21 762	3 553					
Shpenzime per kredite pranë (**, ***, **, *)	293 463	153 990	635 520	917 207	542 724	480 975	899 944	916 296	773 952	773 952	386 976			
Shpenzime udhëtimi Tiranë - Kavajë - Tiranë	17 600	35 200												
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit		50 696	263 461	0	341 456	240 206	13 717	90 227	85 746	0	245 368	189 149	165 180	358 466
Balanca e fondeve (D-C-E)	1 313 080	1 528 231	3 300 538	1 336 921	2 183 634	1 927 647	2 068 028	1 729 791	2 062 624	1 734 876	-1 911 246	3 323 978	2 767 138	3 300 594
Shënim: Në datën e blerjes së pasurisë të llojit trrall, subjekti dhe personi i lidhur paraqiten me balancë negative fondesh në shumën prej -3,408,493 lekë.														